

Terre des hommes

tdh.ch



Save the Children

World Vision®

UDHËZUES

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN
E NJËSIVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE
NË NIVEL LOKAL (BASHKI/KOMUNA)



with funding from

Austrian

Development Cooperation



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

unicef



OAK
FOUNDATION

medicorfoundation

SWISSLOS
Basel-Landschaft

Përgatitur nga: Blerta Spahiu, Amarilda Nakuçi dhe Enkelejda Lopari

Disenjimi & Faqosja nga: Eduart Strazimiri

Dhjetor 2012

Tabela e Përmbajtjes

PARATHËNIE	5
AKRONIME	7
“FJALORTH” - TERMA TË PËRDORUR NE KËTË UDHËZUES	8
PËRMBAJTJA DHE QËLLIMI I UDHËZUESIT	10
PJESA I:	
KORNIZË E PËRGJITHSHME E MODELIT TË MBROJTJES SË FËMIJËVE NË SHQIPËRI	13
MBROJTJA SOCIALE DHE KUADRI LIGJOR	14
Baza ligjore e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve	14
Mekanizmat e Mbrojtjes së Fëmijëve Kontribuojnë në Forcimin e Programeve të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri	15
Çfarë është Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve	16
Detyrat e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Mjetet e Punës	17
MJETET E DOMOSDOSHME TË PUNËS SE PMF-së	17
Parimet Kryesore të Punës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve	18
Menaxhimi i Rastit dhe Puna në Grup MultiDisiplinar	20
Supervizimi i Punës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve	21
Raportimi i Punës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve	22
AKTORËT KYÇ DHE MEKANIZMI PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË SHQIPËRI	23
PUSHTETI VENDOR	26
Çfarë është Pushteti Vendor dhe si Administrohet?	26
Financimi i Njësive të Qeverisjes Vendore	27
Këshilli i Bashkisë/Komunës, Roli dhe Përgjegjësitë e Tij	28

PJESA II:	
PROCESI PËR NGRITJEN E NJËSISË PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE	31
NGRITJA E NJËSISË PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE; NJË PROCES HAP PAS HAPI	32
Njësiti e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Buxheti për më tepër vëmendje ndaj Fëmijëve	37
Modele të Bashkëpunimit për Ngritjen dhe Zhvillimin e NJMF-ve	39
RITJA E KAPACITETEVE TË PUNONJËSVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE TË TYRE	40
Paketa e Trajnimit Orientues Bazë për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve	41
Moduli i Trajnimit për Aktorët e Mbrojtjes së Fëmijëve	42
SHTOJCA	43
Shtojca 1 - Detyrat dhe Përgjegjësitë e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve	44
Shtojca 2 - Detyrat, Funkcionet dhe Format e Bashkëpunimit të Aktorëve Kyç për Mbrojtjen e Fëmijëve	45
Shtojca 3 - Pushteti Vendor dhe Funkcionet e Njësive të Qeverisjes Vendore	49
Shtojca 4 - Ngritja dhe Funkcionimi i NjMF-ve, Një Proces Hap pas Hapi	51
Shtojca 5 - Ndërtimi i Kapaciteteve të Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve	54
REFERENCAT	57
Ligj Nr.10 347, dt. 4.II.2010, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës"	58

Parathënie

Ngritja dhe funksionimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, jo vetëm se i përgjigjet kërkesave të Ligjit 10 347, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, por edhe sepse tashmë konsiderohet si një strukturë e shërbimeve sociale që ofron shërbime dhe koordinon përpjekjet për parandalimin dhe mbrojtjen më të mirë të fëmijëve nga abuzimi, dhuna, neglizhimi, shfrytëzimi, trafikimi etj.

Deri më sot Shqipëria numëron rreth 125¹ Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve të ngritura në nivel lokal, në *Bashki dhe Komuna*. Respektivisht këto njësi i gjejmë në bashkitë e *Durrësit, Fierit, Kuçovës, Beratit, Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës*, në Njësinë Bashkiake Nr. 4 dhe Nr. 9 në *Tiranë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Peshkopi, Kukës dhe Shkodër*. Ndërsa në nivel komune, ato janë ngritur në komunat *Balldre, Kolsh, Zejmen të rrethit Lezhë, Kurbin (Milot), Dermenas, Levan (Fier), Qendër, Novoselë (Vlorë), Tomina (Dibër), Shirgjan, Gjinar, Papërr, Shushicë (Elbasan), etj.*

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në bashkëpunim me UNICEF, ADA (Austrian Development Agency) e donatorë të tjerë kanë mbështetur organizatat e shoqëria civile si *Terre des hommes, Save the Children, Partnerë për Fëmijët, Alb-aid, World Vision Albania* në aktivitetin që ato kanë ndërmarrë për ngritjen dhe funksionimin e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në *Bashki dhe Komuna*. Këto nisma kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë gjithashtu një mundësi shumë e mirë burimore për të krijuar ekspertizë profesionale dhe për të identifikuar praktikatat e mira në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe në promovimin e mirëqënies së tyre.

Terre des hommes (Tdh) është një nga organizatat që ka dhënë kontributin e saj në ngritjen dhe funksionimin e 10 Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, 9 prej tyre të ngritura në *Bashki dhe 1 në Komunë*. Organizata nisi punën e saj në Shqipëri në vitin 1993 duke zbatuar një sere projektesh që adresojnë çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Duke ndërtuar mbi praktikën dhe suksesin e projektit të mëparshëm TACT2, i cili arriti rezultate të qenësishme në adresimin e trafikimit të fëmijëve shqiptarë drejt Greqisë, tashmë fokusi i aktiviteteve të Tdh në Shqipëri është zhvendosur drejt ndërtimit të një Rrjeti për Mbrojtjen e Fëmijëve (njohur ndryshe si “*Projekti CPSN*”). Ky projekt kontribuoi në ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës funksional për mbrojtjen e fëmijëve, ku Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve janë strukturat bazë institucionale të vendosura në nivel lokal dhe ku aktorë të disiplinave të ndryshme dhe komunitetet lokale informohen, fuqizohen dhe ndërmarrin aktivisht masat dhe ndërhyrjet e duhura për mbrojtjen e fëmijëve.

Save the Children është një organizatë që jep ndihmesën e saj në përmirësimin e situatës së fëmijëve në Shqipëri prej vitit 1999, e fokusuar kryesisht në fushën e Edukimit, Mbrojtjes dhe Të drejtave të Fëmijëve. *Save the Children* ofron aktualisht mbështetje për funksionimin e 6-të NJMF në nivel Bashkie. Përpjekjet e *Save the Children* në promovimin dhe zhvillimin e programeve efektive të mbrojtjes për fëmijët dhe të rinjtë, duke synuar reduktimin e vulnerabilitetit të tyre ndaj abuzimit, shfrytëzimit dhe trafikimit kanë nisur prej vitit 2002 në kuader të programit

Rajonal CTRP (Programit në përgjigje të trafikimit). Duke vijuar me programin e Qendrës Sociale Edukative për Integrim në Kinostudio dhe qendrës ditore për fëmijët në situatë rruge, Save the Children ka ofruar shërbime të fokusuar në krijimin e ambjenteve të sigurta për fëmijët me arritje thelbësore në rritjen e aftësive mbrojtëse të fëmijëve e të rinjve ndaj rreziqeve si dhe përfitimit nga shërbimet publike. Save the Children ka dhënë kontributin e saj, së bashku me aktorë të tjerë në ngritjen dhe fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet krijimit dhe fuqizimit të mekanizmave në nivel lokal sic janë NJMF-të.

World Vision (WV) ka mbështetur NJMF-të në Shqipëri që nga viti 2008, përmes një programi dhe burime mbështetëse, financiare, materiale dhe ndërtimi kapacitetesh. Në Shqipëri, WV ka filluar aktivitetin e saj që në vitin 1999 me programe të ndryshme në fushën e Edukimit, Shëndetit, Emergjencave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve. Gjatë këtyre viteve një theks i rëndësishëm i është vënë programit të mbrojtjes së fëmijëve dhe specifikisht advokimit për fuqizimin dhe zgjerimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë hapjen dhe mbështetjen e NJMF-ve si një nga hallkat kryesore të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve. Aktualisht, WV në Shqipëri ka në ngritjen dhe funksionimin e 15 NJMF-ve në nivel komune dhe vazhdon të mbështesë forcimin e NJMF-ve dhe sistemit të MF në 11 rajone të Shqipërisë, duke sjellë zërin dhe nevojat e fëmijëve, familjeve dhe komunitetit në nivel kombëtar për përmirësimin e politikave që ndikojnë drejtpërdrejtë mirëqënien e fëmijëve.

Mbështetur në ekspertizën e fituar si rezultat i angazhimit në këto procese dhe duke u udhëhequr nga Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve përgjegjësitë e aktorëve kryesore dhe rolin e tyre në sigurimin, zgjerimin dhe konsolidimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve brenda kuadrit të decentralizimit të këtyre shërbimeve, Terre des hommes në partneritet me organizatat Save the Children (ScH) dhe World Vision në Shqipëri ndërmorrën nismën për përgatitjen e këtij udhëzuesi.

Ky udhëzues është hartuar për t'i ardhur në ndihmë në radhë të parë drejtuesve të pushtetit lokal, të cilët janë të përfshirë në proceset e ngritjes dhe mbështetjes së Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki dhe Komuna në mënyrë të drejtpërdrejtë. Njëkohësisht, ky udhëzues u shërben të gjithë atyre institucioneve dhe organizatave në nivel lokal dhe qëndror të cilët kanë rol dhe përgjegjësi në mbështetjen e ngritjes së NJMF-ve, ngritjen e kapaciteteve të personelit dhe të gjithë strukturave që kanë si detyrë mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Si i tillë ai synon të ofrojë një guidë praktike të procesit për ngritjen e këtyre strukturave, të kombinuar me informacion të përgjithshëm mbi konceptin dhe mënyrën e funksionimit të tyre brenda kuadrit të përgjithshëm të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri. Hartimi i këtij udhëzuesi është bërë i mundur falë punës së madhe dhe të palodhur të personelit të këtyre organizatave të cilët punojnë dhe mbështesin në mënyrë të vazhdueshme punën e punonjësve të NJMF-ve në terren. Gjithashtu, ky model ka marrë mbështetjen e partnerëve lokalë dhe kombëtarë, sidomos punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve në bashki dhe komuna, përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe mbështetësve kryesore të kësaj nisme që besuan në efektivitetin e këtij modeli dhe dhanë kontributin e tyre për vënien e tij në jetë.

Për këtë arsye Tdh, ScH dhe WV dëshirojnë të sjellin këtë udhëzues edhe si një mënyrë për të festuar përpjekjet dhe suksesin e përbashkët të të gjithë atyre që kanë kontribuar për ndërtimin e këtij modeli, si institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe individët, pa kontributin e të cilëve, ky model nuk do të ishte funksional.

1 Kjo shifër i referohet raportimit të fundit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Duhet theksuar se jo të gjitha NJMF-të kanë një punonjës social me kohë të plotë.

Akronime

ADA – Agjencia Austriake e Zhvillimit

AS – Administratorë Social

NJMF – Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve

PMF – Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve

TACT – Transnational Actions Against Child Trafficking

Tdh – Terre des hommes

UNICEF – United Nation's Children Fund

WVA – World Vision Albania

“Fjalorth” - Terma të Përdorur në Këtë Udhëzues

Ky seksion i dedikohet termilogjisë së përdorur në këtë udhëzues dhe përkufizimeve përkatëse për to. Autorët marrin parasysh faktin se kjo terminologji nuk është tërësisht e re apo e panjohur për pjesën më të madhe të përdoruesve të këtij lexuesi, si dhe përkufizimet e dhëna mund të jenë të limituara, pasi mund të ekzistojnë disa përkufizime për çdo term. Qëllimi është të ofrohet një platformë e njehësuar e kuptimit që këto terma kanë marrë në këtë dokument për të lehtësuar leximin dhe interpretimin e këtij materiali.

“Pushteti lokal” – përfaqësohet nga njësitë të cilat janë Bashkia dhe Komuna

“Bashkia” – Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh kryesisht në zona urbane e në raste të veçanta përfshin edhe zona rurale. Shtrirja territoriale dhe emri i bashkisë përcaktohen me ligj. Nëndarjet e bashkisë në zona urbane quhen lagje. Lagjet krijohen në territore me mbi 15 000 banorë me vendim të këshillit bashkiak. Kur bashkia përfshin zona rurale, nën-ndarja quhet fshat. Fshati krijohet në një territor me mbi 200 banorë. Qytet, shpallet një qendër banimi e cila ka një plan perspektiv zhvillimi urban të miratuar. Shpallja e qytetit bëhet me ligj¹.

“Komuna” – Komuna përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh, si rregull në zona rurale dhe në raste të veçanta edhe në zona urbane. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e komunës përcaktohen me ligj. Nëndarjet e komunës quhen fshatra dhe në raste të veçanta qytete. Përcaktimi i territorit të nëndarjeve bëhet nga këshilli komunal².

“Qarku” – Qarku është njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore³. Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa komuna dhe bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhen me

¹ Ligji Nr. 8652, dt.31.07.2002- Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Vendor

² Idem

³ Idem

kufijtë e komunave dhe të bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut vendoset në një nga bashkitë që përfshihen në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj.

“Mbrotjtja e Fëmijës” – përfshin të gjitha veprimet kundër shfrytëzimit, abuzimit, trafikimit, dhunës apo çdo forme tjetër që cënon zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijës.

“Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve” – është punonjësi i punësuar nga Bashkia/Komuna, është punonjës me formim në punë sociale, Ligji Nr. 8652, dt.31.07.2002 - Ligj për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Vendorle dhe për t’i ardhur në ndihmë fëmijëve dhe për t’iu përgjigjur nevojave të tyre për mbrojtje.

“Menaxhimi i Rastit” – Menaxhimi i rastit është një metodologji që siguron hap pas hapi ofrimin e vazhdueshëm e efektiv të ndihmës për individët në nevojë (fëmijë, të rritur apo familje) dhe synon të promovojë e të nxitë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqënien e personit. Menaxhimi i rastit në punën për mbrojtjen e fëmijëve mbështetet dhe drejtohet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, mbështetet në nevojat e tij, ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si edhe në bashkëpunimin e ngushtë mes aktorëve të ndryshëm, që kanë një ndikim në jetën e fëmijës përfshirë prindërit, mësuesit, personelin shëndetësor, anëtarë të tjerë të familjes, etj.

“Nëpunës Civilë” – sipas këtij kodi janë ata nëpunës të institucioneve të administratës të nivelit qendror apo vendor, të cilët ushtrojnë autoritetin publik në detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse dhe ekzekutuese.

“Grupi Multidisiplinar” – grupi i aktorëve të cilët janë përfaqësues të instucioneve lokale, rajonale dhe organizatave jofitimprurëse që marrin pjesë në takimet për mbrojtjen e fëmijëve sipas problematikave dhe nevojave të rastit, lehtësojnë dhe ofrojnë shërbimet e nevojshme për fëmijën në nevojë për mbrojtje.

“Rezilienca” – (ose Rezistenca), janë aftësitë që ndihmojnë dhe i mundësojnë fëmijës të përballet dhe t’i mbijetojë dëmtimeve, vështirësive dhe disavantazheve. Në njëfarë mënyre është zhvillimi normal i fëmijës edhe pse rritet në rrethana të vështira.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve është strukturë e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Ndhmës Ekonomike pranë Bashkisë/Komunës e ngritur në bazë të ligjit nr. 10 347 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

Ajo përfaqësohet nga një Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve/punonjës social, i/e cili në bashkëpunim dhe koordinim me aktorë të tjerë publikë dhe private, merr masa mbrojtëse për fëmijët, të cilët ndodhen në situatë abuzimi, neglizhimi, dhune, trafikimi e përjashtimi social.

Përmbajtja dhe Qëllimi i Udhëzuesit

Ky udhëzues ka për qëllim të orientojë, mbështesë dhe lehtësojë përpjekjet dhe iniciativat e ndërmarra për ngritjen e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel lokal (bashki dhe komuna), duke marrë në konsideratë kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të siguruar funksionimin e plotë të tyre, të udhëhequr nga parimi i Interesit më të Lartë të Fëmijës.

Si i tillë, ky udhëzues u shërben së pari atyre aktorëve që kërkojnë mënyrën praktike të ngritjes së kësaj strukture në mënyrë sa më të qëndrueshme dhe efektive, bazuar mbi kuadrin përkatës ligjor, në përgjigje të nevojave të fëmijës dhe familjes. Po ashtu ky udhëzues mund t'u vijë në ndihmë të gjithë atyre që kanë nevojën dhe dëshirën të kuptojnë, mësojnë dhe njohin më thellë modelin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, mekanizmave lokalë ekzistues që vënë në zbatim këtë model dhe në veçanti rolin dhe funksionimin e NJMF-ve.

Proçesi për ngritjen dhe funksionimin e NJMF-ve është kompleks dhe përfshin një sërë hallkash e aktorësh, bazuar në ligje, udhëzime dhe rregullore të pushtetit qendror, rajonal dhe lokal.

Për rrjedhojë, ai kërkon zbatimin e një qasje shumë-dimensionale dhe njëkohësisht praktike. Pikërisht duke e konsideruar ngritjen dhe funksionimin e NJMF-ve një proçes, ky udhëzues do të përmbajë informacion dhe praktika të hasura kryesisht nga organizata Terre des hommes, të organizuara në formën e hapave, brenda kornizës ligjore që mbështet dhe lehtëson ngritjen e kësaj strukture.

Ky udhëzues është i ndarë në dy pjesë kryesore:

Pjesa e parë jep informacion të përgjithshëm mbi strukturën e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, në raport me kuadrin ligjor dhe skemën e mbrojtjes sociale, si dhe parimet që udhëheqin punën e NJMF-ve. Ai diskuton rolin dhe përgjegjësitë kryesore të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe ofron informacion mbi proceset dhe metodat kryesore të punës së tij. Gjithashtu ky udhëzues, përmban edhe një pasqyrë të përgjithshme të hallkave që përbëjnë sistemin e mbrojtjes në të gjitha nivelet dhe aktorët kyç që duhet të përfshihen në procesin e sigurimit të mbrojtjes së fëmijëve.

Pjesa e dytë ofron një përshkrim të procesit hap pas hapi, duke përfshirë procedurat, modelet e bashkëpunimit dhe metodat e përdorura në praktikën e deritanishme për hapjen dhe mbështetjen e NJMF-ve në Bashki dhe Komuna. Të gjitha hapat dhe procedurat e diskutuara në këtë dokument janë të shoqëruara me shembuj praktikë dhe mjete pune të testuara në praktikë, të cilat janë të organizuara dhe gjenden në shtojcën e këtij udhëzuesi.

Një vëmendje të vecantë merr edhe puna për mbështetjen dhe edukimin e vazhduar të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve, përmes procesit të ndërtimit të kapaciteteve që ka si synim trajnimin, shoqërimin dhe mentorimin e tyre për të siguruar shërbim të qëndrueshëm e cilësor të mbrojtjes së fëmijëve. Si rrjedhojë, programi i trajnimit dhe përgatitjes së PMF-ve ndodhen në shtojcën e këtij udhëzuesi.

Së fundmi, ky udhëzues ka edhe një seksion të veçantë që quhet “Shtojca”, i cili përmban të gjitha mjetet, modelet dhe materialet e tjera praktike, që do t’u vijnë në ndihmë dhe mund të përdoren si modele bazë për të bërë të mundur zbatimin në praktikë të gjithë procesit të përshkruar në këtë udhëzues.

Terre des hommes shpreson se ky udhëzues do të përmbushë me sukses misionin e tij dhe do të plotësojë nevojën për orientim dhe dije të të gjithë atyre që tashmë kanë nisur rrugëtimin fisnik dhe sfidues të ndërtimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

PJESA I



**Kornizë e
Përgjithshme e
Modelit të Mbrojtjes së
Fëmijëve në Shqipëri**

Mbrojtja Sociale dhe Kuadri Ligjor



Baza Ligjore e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve

Duke nënshkruar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) shteti Shqiptar mori përsipër të mbrojë dhe të sigurojë realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të organizojë forma të ndryshme të përkujdesit për ta. Nevoja për të ngritur tipologji të ndryshme shërbimesh ka vënë një sfidë të madhe përpara politikë-bërësve dhe drejtuesve të pushtetit vendor pasi nevojat janë të shumta dhe burimet të pakta.

Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, neni 54, pika I, fëmijët gëzojnë të drejta dhe mbrojtje të veçantë nga shteti. Gjithashtu Kushtetuta parashikon mbrojtje të veçantë për fëmijët e dhunuar, të keqtrajtuar dhe që shfrytëzohen ekonomikisht. Aktiviteti dhe qëllimi i NjMF-ve përputhet me qëllimin e ligjit “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe përkon nën përkufizimin e “shërbimeve shoqërore në komunitet”⁴ Fëmijët në nevojë janë përfytyrues të shërbimeve shoqërore⁵.

Një peshë të madhe dhe rol për mbrojtjen e fëmijëve i caktoi NjMF-së miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, Nr.10 347, datë 4.11.2010. Ky ligj ka për qëllim të ofrojë “mbrojtje të veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe legjislacionit në fuqi; marrjen e masave për t’i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave në përputhje me zhvillimin dhe personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij; marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës si dhe sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.”

Neni 5 e njuh dhe e parashikon “interesin më të lartë të fëmijës si konsideratë parësore në të gjitha vendimet për fëmijët përfshirë ato të autoriteteve administrative.” Gjithashtu parime të tjera të ligjit 10347⁶, të bazuara dhe në parimet e KDF-së janë: *barazia dhe mos diskriminimi; eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit ose ndëshkimit ndaj fëmijëve; respektimi i përgjegjësive dhe të drejtave që kanë prindërit dhe përfaqësuesit ligjorë të fëmijëve; krijimi i kushteve për mbijetesë maksimale dhe zhvillim dhe së fundmi parimi i respektimit të mendimit të fëmijës në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.*

Në Kreun 4, Neni 32 i ligjit “Mekanizmat Institucionale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, Qarku dhe Komunat shihen si institucione të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijëve. Ndërkohë në pikën 4 të këtij Neni, parashikohet nevoja për koordinim midis strukturave të të gjitha niveleve. Megjithatë në ligj nuk parashikohen detaje të mëtejshme mbi funksionimin dhe marrëdhëniet e këtyre njësive pasi ishte parashikuar pasurimi i tij me akte nën-ligjore, pas miratimit të ligjit. Këto akte tashmë janë hartuar dhe konsultuar me aktorë të shoqërisë civile, shërbim-ofrues, etj., dhe pritet të miratohen së shpejti. Neni 39 i këtij ligji përcakton detyrat kryesore të NjMF-së.

Ligji parashikon “ngritjen e grupeve multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e bashkisë/komunës” për të mbështetur punën e NjMF-së dhe për të ndjekur trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.

⁴ Ligji Nr. 9355 për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore, datë 10.03.2005, Neni 4, Pika 15

⁵ Ligji Nr. 9355 për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore, datë 10.03.2005 Neni 6, dhe Neni 13, pika I

⁶ Ligji 10347, Neni 4, Datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.



Mekanizmat e Mbrojtjes së Fëmijëve Kontribuojnë në Forcimin e Programeve të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri

Një sërë fenomenesh ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve në Shqipëri. Një numër i lartë fëmijësh jeton në varfëri, një pjesë e fëmijëve vuajnë nga dhuna në familje, në shkolla dhe komunitet. Raportet nga burime të ndryshme nxjerrin në pah ekzistencën e vazhdueshme të formave të rënda të shfrytëzimit të fëmijëve në Shqipëri duke përfshirë lypjen e detyruar dhe trafikimin⁷.

Faktorët që kontribuojnë në neglizhimin, abuzimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve nuk lidhen vetëm me kushtet e vështira ekonomike, por i kanë rrënjët më së shumti në varfërinë e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve ku ata jetojnë dhe rriten. Koncepti i varfërisë është më i gjerë se mungesa e të ardhurave financiare. Ajo përfshin edhe mungesa të tjera si mohimi i të drejtave të fëmijëve, mungesa e aksesit në arsimim cilësor, kujdes shëndetësor, ushqyerje të mirë, mungesa e mundësive për pjesëmarrje dhe mbrojtje nga dëmtimet, shfrytëzimi dhe diskriminimi. Megjithatë matjet monetare të varfërisë janë matje me vlerë dhe të rëndësishme, ato nuk arrijnë të tregojnë sesi varfëria ndikon fëmijët në aspektin fizik, emocional dhe social.

Mbrojtja sociale, sipas një studimi të Organizatës Botërore të Punës, është një çështje e diskutueshme⁸. Ajo përfshin një sërë ndërhyrjesh për të zbutur përjashtimin social dhe ekonomik që bazohen në “identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe mënyrën se si ato zhvillohen përgjatë ciklit të jetës”⁹. Programet e mbrojtjes sociale me fokus fëmijët marrin në konsideratë dimensionet e ndryshme të mirëqenies së fëmijëve dhe bazohen në analizën e të dhënave në mënyrë që të maksimizojnë rezultatet e zhvillimit për fëmijët. Mbrojtja e fëmijëve duhet të jetë një komponent i mbrojtjes sociale.

Koncepti i mbrojtjes sociale në Shqipëri ka ndryshuar me kohën. Në vitet e fundit qeveria shqiptare ka zhvilluar politika, strategji, ka ndërmarrë reforma dhe ka ngritur institucione e shërbime për të trajtuar problemet e reja sociale që erdhën me tranzicionin. Politikat dhe strategjitë janë përpjekje pozitive për krijimin e mekanizmave që u vijnë në ndihmë fëmijëve të cilët janë veçanërisht të rrezikuar dhe të përjashtuar, megjithatë vetëm pak programe sociale janë bazuar në një analizë të mirëfilltë të aspekteve multidimensionale të vulnerabilitetit të fëmijëve, duke mos arritur të ndikojnë në mënyrë efektive përjashtimin social dhe varfërinë kronike që transmetohet ndër breza.

NjMF-ve zbaton një model të shërbimeve dhe të punës sociale të projektuar për të mbështetur familjet dhe fëmijët në nevojë¹⁰. Ajo ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi, nxitur nga interesi më i lartë dhe të drejtat themelore të fëmijës.

NjMF-ja ka një qasje gjithëpërfshirëse ndaj vështirësive të familjeve dhe synon të përmirësojë mjedisin mbrojtës familjar, përmes ndërhyrjeve parandaluese dhe trajtuese. Praktika

7 TRAFFICKING IN PERSONS REPORT 2011- US Department of State, <http://www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2011/164231.htm>

8 B and Gruat, J.V 2003 ‘SOCIAL PROTECTION - A Life Cycle Continuum Investment For Social Justice, Poverty Reduction And Sustainable Development.

9 Jones, N, 2009 ‘PROMOTING SYNERGIES BETWEEN CHILD PROTECTION AND SOCIAL PROTECTION – West and Central Africa’ UNICEF, Overseas Development Institute.

10 Westwater, G and Jovanović, V, 2009 ‘EVALUATION OF CHILD PROTECTION UNIT INTERVENTION within the framework of welfare system reform and decentralization of social services in Albania’, Albania.

bashkëkohore dhe modeli i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, i pilotuar tashmë në Shqipëri, propozon një mundësi të mirë për të krijuar sinergji mes programeve të mbrojtjes sociale, duke kontribuar në përmirësimin e tyre dhe për t'i bërë ato më të ndjeshme ndaj fëmijëve.



Çfarë Është Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve është pjesë e strukturës së Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Ndhmës Ekonomike në Bashki/Komuna. Ajo ofron shërbime sociale mbrojtëse për fëmijet dhe familjet me banim të përhershëm apo të përkohshëm brenda territorit ku zbaton përgjegjësitë e saj si dhe synon të promovojë të drejtat dhe mirëqënien e fëmijëve.

Qëllimi i punës së njësisë është mbrojtja e fëmijëve ndaj çdo lloj forme abuzimi, neglizhimi, përjashtimi social, shfrytëzimi, trafikimi dhe fenomeneve të tjera që çënojnë zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijëve. Fëmijët dhe familjet që kanë nevojë për ndihmë mund të drejtohen pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve për të marrë informacion apo për t'u referuar tek shërbime të tjera mbështetëse sipas nevojave që ata kanë.

Shërbimet e NjMF-së janë pjesë e programeve më të gjera të mbrojtjes sociale dhe kontribuojnë në forcimin e tyre në këto aspekte: ndërhyjnë në një fazë të hershme, kur fëmijët konsiderohen në rrezik, duke parandaluar në këtë mënyrë dëmtimet e pakthyeshme që vijnë si rezultat i dhunës apo dëmtimit; arrijnë të zvogëlojnë efektet e përjashtimit social dhe varfërisë që prek familjet, duke i referuar këto familje tek shërbimet e ndihmës ekonomike ose përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë me ushqime, veshje apo strehim; mbështet si fëmijën ashtu edhe familjen duke e ndihmuar këtë të dytën të përfitojë nga shërbimet bazë, të tilla si kujdesi shëndetësor, arsimi, shërbime të punësimit etj; ofron shërbime për fëmijët me vulneraëbl.


Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve përfaqësohet nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF), i cili bashkëpunon ngushtë me supervizorin, Drejtuesin e Shërbimit Social dhe Ndhmës Ekonomike të Bashkisë/Komunës, me Administratorët Socialë dhe sektorët e tjerë si Sektori i Dhunës në Familje, Sektori për Minoritetet, Sektori për të Rinjtë etj. Administratorët Socialë mund t'i vijnë në ndihmë Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve nëpërmjet identifikimit dhe referimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje; kryerjes së vizitave të përbashkëta pranë familjeve; propozimit për përfshirje në skemën e ndihmës ekonomike për ato familje që megjithëse nuk i plotësojnë kriteret kanë nevojë për ndihmë te veçantë, sidomos në plotësimin e nevojave të fëmijës.



Detyrat e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Mjetet e Punës

Detyrat dhe përgjegjësitë e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve janë përcaktuar në Ligjin 10347, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” dhe në praktikën e rolit dhe funksionit të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve. Punonjësi për Mbrojtjen e fëmijëve ka për detyrë kryesore:

- të identifikojë rastet e fëmijëve që janë në situatë rreziku apo në nevojë dhe të ndërhyjë për menaxhimin e rastit, së bashku me ekipin multi-disiplinar, duke bërë ndjekjen dhe referimin e tij në hallkat përkatëse deri në zgjidhjen përfundimtare;
- të mobilizojë të gjitha strukturat lokale dhe të lehtësojë punën e rrjetit për mbrojtjen e fëmijëve dhe
- të ndërmarrë në bashkëpunim me aktorët lokalë ndërhyrje për ndërgjegjësimin e komunitetit për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe adresimin e shkaqeve të tyre.



(Një listë e plotë e detyrave dhe përgjegjësiave sic janë të përcaktuara në ligj gjendet në Shtojcën e këtij udhëzuesi).

Mjetet e Domosdoshme të Punës së PMF-së

Për të kryer funksionin e tij Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve mbështetet në dy instrumenta ndihmëse kryesore që janë:

- ✓ *Prokollli i Punës së Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe*
- ✓ *Sistemi i Hedhjes, Përdorimit dhe Përpunimit të të Dhënave.*

Protokolli për Mbrojtjen e Fëmijëve është hartuar për t’iu ardhur në ndihmë të gjithë personave që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, veçanërisht punonjësve të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashki/komune. Ky protokoll përcakton një metodë të standardizuar për menaxhimin e rasteve përmes punës shumë-disiplinore për identifikimin, praktikimin dhe rishqyrtimin e ndërhyrjeve mbrojtëse për fëmijët dhe siguron një sistem të besueshëm për mbledhjen e të dhënave.

Krahas protokollit, PMF-ve ka në dispozicion edhe një Sistem Elektronik të Hedhjes së të Dhënave për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të marrë në mbrojtje. Ky sistem elektronik shërben si një udhëzues për procesin e menaxhimit të rastit, si dhe si një mjet për raportimin statistikor dhe cilësor të punës në menaxhimin e rasteve.

PMF-të, si punonjës i administratës së qeverisjes vendore kanë për detyrë të japin ndihmesën e tyre në procesin e mbledhjes së të dhënave për fëmijët dhe/apo familjet që jetojnë brenda zonës së tyre gjeografike. Të dhënat e mbledhura shërbejnë në radhë të parë për ndjekjen dhe monitorimin e rasteve individuale dhe ofrojnë informacion për numrin dhe llojet e rasteve që janë ndjekur nga NJMF-të. Së dyti, këto të dhëna japin informacion edhe për problematikat specifike të lidhura me abuzimin ndaj fëmijëve në kontekstin social, ekonomik dhe kulturor të komunitetit veçanërisht të fëmijëve dhe problematikat që prekin mirëqënien e tyre.

I gjithë ky informacion i shërben NJMF-ve për të bërë një vlerësim dhe analizë më të thelluar të situatës së fëmijëve dhe familjeve në zonë dhe për të nxitur e koordinuar inisiativa në bashkëpunim me aktorët lokalë, të cilat promovojnë mbrojtjen dhe mirëqënien e fëmijëve.

Të dhënat statistikore që prodhohen nga PMF-të i përkasin Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkisë/Komunës. Nëpërmjet raportimeve këto të dhëna shpërndahen në struktura të tjera në nivel qendror dhe rajonal. Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit statistikor nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe ndarjen e raporteve me strukturat përkatëse dhe aktorët e intersuar sipas akteve nënligjore të Ligjit 10347.

Ndërkohë që informacioni në lidhje me menaxhimin e rasteve, ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjen, vendosjen e fëmijëve në institucone rezidenciale etj, duhet të ndahet me Shërbimin Social Rajonal dhe atë Shtetëor. Kjo për arsye sepse dhe NJMF është një formë e shërbimeve sociale me synim mbrojtjen e fëmijëve dhe mbështetjen e familjeve në rrezik.



Parimet Kryesore të Punës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve ushtron funksionin, rolet dhe përgjegjësitë bazuar në disa parime kryesore, të cilat sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e tyre. Këto parime janë si me poshtë:

- ✓ **Interesi më i lartë i fëmijës.** Ky parim sugjeron se në çdo veprim, vendim apo ndërhyrje duhet të mbahet si konsiderata më e rëndësishme dhe mbizotëruese interesi më i lartë i fëmijës.
- ✓ **Mundësia dhe trajtimi i barabartë.** Shërbimet duhet të planifikohen dhe të ofrohen sipas nevojave të fëmijëve dhe familjeve të tyre pa dallim rrace, feje, gjinie, vendndodhje, moshe dhe aftësie. Të gjithë fëmijët do të marrin të njëjtin nivel shërbimesh ose ndihme dhe nuk do të diskriminohen si rezultat i statusit që kanë.
- ✓ **Konfidencialiteti.** Informacioni për fëmijën i marrë nga NJMF-të përdoret për të përcaktuar nevojat e fëmijës me qëllim mbrojtjen e tij/saj nga dëmtimet. PMF merr të gjitha masat për ruajtjen e privatësisë dhe identitetit të fëmijës. Shpërndarja e këtyre të dhënave

është e kufizuar dhe bëhet vetëmn duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës me aktorët të cilët e kanë të domosdoshme dhe të nevojshme ndarjen e informacionit.

- ✓ **Respektimi dhe promovimi i të drejtës së fëmijës për mbrojtje, kujdes dhe për t'u dëgjuar.** Aktivitetet e NJMF-ve dhe bashkëpunëtorëve të saj duhet të përkrahin gjithmonë të drejtat e fëmijës në përputhje me Ligjin 10347, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës", akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjerë të rëndësishëm. Çdo fëmijë trajtohet me respekt duke marrë parasysh zhvillimin e tij/saj individual, nevojat dhe të drejtat e tij/saj për mbrojtje. Fëmija që është i aftë të formojë pikëpamjet e veta, ka të drejtë t'i shprehë ato lirisht për çështjet dhe vendimet që kanë të bëjnë me të.
- ✓ Akses të thjeshtë në shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve do të kujdeset që çdo rast të merren në konsideratë interesat e fëmijës si dhe të lehtësojë procesin e dhënies së mbështetjes dhe shërbimit fëmijës në nevoje. Mungesa e dokumentacionit për fëmijën ose familjen nuk duhet të jetë një faktor përcaktues për rastet urgjente të fëmijëve në rrezik ose në nevojë për mbrojtje.
- ✓ **E drejta për akses në shërbime cilësore.** Familjet dhe fëmijët kanë të drejtë të informohen për shërbimet që ekzistojnë për to dhe nxiten të marrin pjesë në proceset vendimarrëse që lidhen me to. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve kujdeset që të marrë në konsideratë interesat e fëmijës dhe lehtëson procesin e ofrimit të shërbimit dhe mbështetjes për fëmijën në nevojë dhe familjen e tij.
- ✓ **E drejta për shërbime.** Për çdo shërbim të ofruar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve do të ketë të përcaktuara qartë edhe kriteret për përfitimin e shërbimit. Nëse një fëmijë nuk i ofrohet shërbimi, atëherë familjes dhe fëmijës i duhen paraqitur me shkrim arsyet për këtë vendim. Fëmija ose përfaqësuesi i tij/saj kanë të drejtë ta apelojnë vendimin brenda një afati të caktuar kohor tek autoriteti përgjegjës shtetëror i përcaktuar sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ✓ **Bashkëpunimi dhe partneriteti.** Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve është strukturë përgjegjëse për koordinimin dhe ndërmjetësimin e partneritetit me aktorët e shërbimeve mbrojtëse për fëmijët, për të siguruar mbrojtjen, përmbushjen e të drejtave dhe mirëqënien e fëmijëve dhe familjeve.
- ✓ **Sigurimi i pavarësisë, integritetit shoqëror dhe pjesëmarrjes në jetën e komunitetit.** Në bashkëpunim me aktorë të tjerë, PMF duhet të garantojë që planet individuale të mbrojtjes dhe të përkujdesit për fëmijën të ndikojnë në fuqizimin e familjes në dobi të kujdesit ndaj fëmijës, me qëllim zhvillimin e pavarësisë së tij/saj, inkurajimin për integrim shoqëror dhe pjesëmarrjen në komunitet.
- ✓ **Kontributi i NJMF-ve në vizionin e Bashkisë/Komunës për shërbimet sociale për fëmijët.** PMF duhet të kontribuojë me ide, të dhëna dhe propozime në aktivitetet për hartimin e politikave dhe strategjive për shërbimet sociale për fëmijën dhe familjen në Bashki/Komuna. PMF duhet të kujdeset të përfshijë komunitetin, sipas mundësisë dhe nevojës, në planifikimin dhe dhënien e shërbimeve parandaluese, ndërgjegjësuere dhe mbështetëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.



Menaxhimi i Rastit dhe Puna në Grup MultiDisiplinar

Ndihma e ofruar një fëmije qysh nga identifikimi i tij, bashkë me problematikat që mbart e deri tek zgjidhja e tyre përbën atë që quhet “Menaxhimi i Rastit”. Menaxhimi i rastit është një metodologji e cila siguron hap pas hapi ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për individët në nevojë (fëmijë, i rritur apo familje) dhe që synon të promovojë dhe nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqënien e personit.

Menaxhimi i rastit përfshin masat dhe koordinimin e ndërhyrjeve të ndërmarra nga Punonjësi Social me detyrën për manaxhimin e rastit, duke u udhëhequr nga Interesi më i Lartë i Fëmijës, dhe përfshin specialistët e strukturave dhe shërbimeve publike dhe jo publike si dhe individë që kanë ndikim në jetën e fëmijës, në procesin e identifikimit, vlerësimin të rrezikut dhe nevojave të fëmijës dhe familjes, planifikimin e ndërhyrjeve, zbatimin dhe ofrimin e shërbimit dhe ndihmës, monitorimit si dhe rishqyrtimin e situatës deri në momentin që fëmija nuk është më në rrezik.

Ndjekja e hapave bazë siguron që çdo fëmije t’i ofrohet i njëjti nivel shërbimi dhe mbrojtjeje në mënyrën dhe kohën e duhur, nëpërmjet përfshirjes aktive të grupit multidisiplinar. Grupi multidisiplinar së bashku me PMF-në, marrin vendimin për llojin e ndërhyrjes dhe shërbimet që i duhen ofruar fëmijës, pas një vlerësimi të hollësishëm të nivelit dhe llojit të rrezikut dhe situatës aktuale të fëmijës.

Të gjitha shërbimet e ofruara synojnë të reduktojnë nivelin e rrezikut për jetesën, shëndetin e zhvillimin e fëmijës dhe të përmbushin nevojat konkrete të tyre. Ato janë të kufizuara në kohë dhe rishikohen rregullisht nga grupi multidisiplinar nën drejtimin e PMF-ve.

Menaxhimi i rasteve është dhe duhet të jetë funksioni parësor për çdo NJMF dhe si i tillë ai duhet konsideruar dhe mbështetur fuqimisht nga aktorë të mbrojtjes së fëmijëve të të gjitha niveleve.



Figure 1: Skema e hapave kryesor në Menaxhimin e Rastit



Supervizimi i Punës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve

Supervizimi lidhet me marrjen e përgjegjësisë për udhëheqjen dhe drejtimin bashkëpunues të një stafi të caktuar. Ai siguron që stafi ka burimet e nevojshme për të realizuar punën në mënyrë efikase.

Në rastin e NJMF-ve, këtë përgjegjësi zakonisht e merr Drejtori i Shërbimit Social dhe Ndhmës Ekonomike në Bashki/Komuna, i cili duke qënë në kontakt të përditshëm me NJMF-të dhe strukturat e tjera të shërbimit social realizon supervizimin nëpërmjet të pyeturit, të dëgjuarit, konsultimit, trajnimit, respektit, mbështetjes dhe interesit ndërpersonal. Koncepti mbi rolin e supervisorit ka ndryshuar nga një pozicion vertikal që kryesisht jep urdhëra dhe kontrollon, në një rol drejtues e mbështetës, që motivon dhe ndërton kapacitetet e stafit.

Supervizori duhet të vlerësojë punën e NJMF-së dhe po ashtu Punonjësën e Mbrojtjen së Fëmijëve si person në raport me sjelljen që shfaq dhe punën që bën. Studimet e shumta tregojnë për preferencën e një supervisorit i cili nuk favorizon, kupton nevojat dhe pikat e forta të punonjësve, krijon hapësirën dhe komfortin për punonjësit që të shprehin idetë e tyre lirshëm dhe po ashtu i tregojnë atyre se çfarë duhet të përmirësojnë në punën e tyre.¹¹

Bazuar në këto role dhe qëndrime dhe në natyrën e punës së NJMF-së, supervisorit ka detyrë:

- ✓ Të bashkëpunojë me PMF-të për vlerësimin e rrezikut dhe ndjekjen e planit të kujdesit për fëmijën dhe familjen.
- ✓ Të mbështesë PMF-të për bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimeve me aktorë të tjerë publikë dhe privatë.
- ✓ Të japë kontributin e vet në takimet për diskutimin e rasteve dhe në tryezat teknike mbi çështje dhe problematika të fëmijëve dhe familjeve.
- ✓ Të mbështesë PMF-të në realizimin e marëveshjeve me një palë të tretë sipas nevojave.
- ✓ Të jetë pikë kyçe në krijimin, zhvillimin dhe harmonizimin e një grupi pune social të përbërë nga PMF-ve, Punonjësën e Dhunës, Punonjësën për Minoritetet, Punonjësën për të Rinjtë, Administratorët Socialë¹², etj.
- ✓ Të mbështesë dhe të ndjekë PMF-të për dokumentimin e rasteve të fëmijëve të marrë në mbrojtje; si për krijimin e dosjeve ashtu edhe për hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik.
- ✓ Të ngrejë pyetje dhe të konsultojë PMF-të rreth raportimit mujor.
- ✓ Të orientojë dhe mbështesë PMF-të në kryerjen e vlerësimit të situatës së fëmijëve.
- ✓ Të sigurojë dhe të ndajë informacionin mbi të rejtat apo zhvillimet e fundit mbi aspekte që lidhen drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë me punën e NJMF-së dhe strukturave të tjera të shërbimit social.

Të gjitha këto detyra, supervisorit i kryen nëpërmjet një komunikimi efektiv, vlerësimit dhe vëzhgimit të performancës së PMF-së, menaxhimit të situatave dhe sjelljeve të caktuara, konfrontimit konstruktiv, dhënies së mesazheve, delegimit të punës, frymëzimit dhe vlerësimit të punonjësit, ndërtimit të frymës bashkëpunuese etj.

¹¹ <http://supervisoressentials.com/>

¹² Strukturat e Shërbimit Social ndryshojnë nga një Bashki/Komunë në tjetrën. Kjo është pjesë e decentralizimit të shërbimeve sociale në pushtetin vendor

Supervizimi është një detyrë e përditshme që nëse kryhet me frekuencën, profesionalitetin dhe mbështetjen e duhur teknike garanton ndikim të dukshëm në punën e PMF-së. Meqënëse NJMF-ja është ende një strukturë e re, e cila po ndjek suksesshëm trajektoren e konsolidimit të saj, nevojitet mbështetje teknike e mëtijshme edhe mbi supervizimin.



Raportimi i Punës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve

E gjithë puna e kryer nga NJMF-të raportohet dhe dokumentohet kryesisht me një frekuencë mujore¹³. Raportimi bëhet sipas një formati, i cili bazohet tërësisht në përgjegjësitë dhe detyrat e PMF-së. Raporti mujor përmban informacion përshkrues dhe statistikor. Më specifikisht informacioni përshkrues konsiston në dhënien e informacionit për aktivitete të tipit:

- ✓ **Takime dhe tryeza të rrumbullakëta me aktorë të tjerë.** Jepet arsyeja e takimeve, tryezave, pjesëmarrësit, temat e trajtuara, vendime e konkluzione, çështje të zgjidhura, detyra të lëna për çdo aktor etj.
- ✓ **Ndërtim kapacitetesh dhe trajnime.** Kush e ka organizuar trajnimin, me çfare teme, pjesemarrësit, praktikat e reja, ndarjet e eksepriencave, si trajnimet do të ndikojnë përmirësimin e punës etj.
- ✓ **Përfshirja në procese dhe kontributi i dhënë për hartimin e politikave sociale, strategjive dhe iniciativave lokale për mbrojtjen e fëmijëve.** Çfarë projektesh të reja aplikon Bashkia/Komuna, apo insitucione të tjera lokale, si është realizuar bashkëpunimi, si integrohen shërbimet dhe iniciativat, konsultimet që NJMF-ja ka patur me aktorë të tjerë, planet e përbashkëta të veprimit, etj.
- ✓ **Advokaci për të promovuar të drejtat e fëmijëve.** Cfarë ndërhyrjesh, iniciativash ka ndërmarrë NJMF-ja, në bashkëpunim me aktorë të tjerë për të bërë advokaci për çështje apo problematika të caktuara të fëmijëve, si ka ecur procesi i advokacisë, rezultatet dhe vështirësitë, etj.
- ✓ **Vizitat në familje.** Sa vizita janë kryer, cili ka qënë qëllimi i tyre, vlerësimi në raport me planin e kujdesjes, etj.
- ✓ **Numri total i aktiviteteve sensibilizuese të organizuara në komunitet.** Specifikohet data e kryerjes së aktivitetit, qëllimi, mesazhet e dhëna, një përshkrim i shkurtër i organizimit të tij, numrin e pjesëmarrësve [fëmijë/të rritur] dhe komuniteti, impakti, etj.
- ✓ **Vlerësimi i situatës së fëmijëve.** Informacion të përgjithshme mbi situatën e fëmijëve me probleme në këtë zonë duke përfshirë rezultatet e vlerësimit të nevojave të tyre si dhe hapat e tjera që do të merren në të ardhmen për të zvogëluar ekzistencën e tyre.

Ndërsa raportet statistikore përmbajnë të dhëna për numrin e rasteve të fëmijëve të identifikuar në rrezik dhe problemet e tyre, numri total i fëmijëve të referaur nga NJMF-të në struktura të tjera publike apo private të shërbimit social, numri total i fëmijëve që kanë kaluar nga rreziku i lartë në të mesëm apo në të ulët, numri total i rasteve të menaxhuara me ndihmën e organizatave mbështetëse, numri i dosjeve të mbyllura gjatë një periudhe raportuese, familjet e ndihmuara dhe llojet e ndihmave të dhëna për to dhe së fundi një përmbledhje e rasteve të

¹³ PMF-ja përgatit raporte të tjera sipas nevojave dhe kërkesave. Këto raporte bazohen kryesisht tek raporti mujor dhe sistemi elektronik i ruajtjes së të dhënave.

ndjekura në kohë (rastet e reja, rastet e referuara, raste të rihapura, raste të mbyllura dhe totali i dosjeve të hapura).

Një model i një raporti mujor me të dhëna përkshkruese dhe statistikore gjendet në Shtojcën e këtij udhëzuesi.

Aktorët Kyç dhe Mekanizmi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Shqipëri

Për të patur rezultate në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe për funksionimin efektiv të NJMF-ve është i rëndësishëm bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimeve ndërmjet aktorëve të ndryshëm në nivel qendror, rajonal dhe atë lokal, përfshi këtu aktorët publikë dhe privatë.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Në nivel qendror, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është insitucioni më i rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo agjenci është në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe lidhet direkt me strukturat lokale dhe rajonale të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Detyrat kryesore të saj janë monitorimi i zbatimit të ligjit Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe hartimi i politikave që mbështesin dhe avancojnë çështjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri; ndërtimi i mekanizmave dhe koordinimi i punës me institucionet përkatëse për mbledhjen, përpunimin dhe pasqyrimin e informacionit për ecurinë e zbatimit të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre përmes raporteve periodike, studimeve të thelluara dhe kërkimit shkencor; koordinimi dhe bashkërendimi i punës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve mes aktorëve publikë, shoqërisë civile dhe atyre publikë, si dhe të organizojë veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit gjyqësor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera. *Për informacion më të detajuar mbi detyrat e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ju lutem referojuni Shtojcës.*

Aktorë në nivel rajonal dhe roli i tyre¹⁴:

Në nivel qarku veprojnë Njësia për të Drejtat e Fëmijëve në Këshillin e Qarkut, Grupet Multi-disiplinare për Mbrojtjen, Referimin dhe Analizën e rasteve të Fëmijëve në rrezik dhe Observatori për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Këto institucione punojnë në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe kanë si qëllim bashkërendimin e punës me Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel bashkie/komune për të siguruar mbrojtjen efektive të fëmijëve.

Njësia për të Drejtat e Fëmijëve në Këshillin e Qarkut

Njësia për të Drejtat e Fëmijës kryen veprimtarinë e saj brenda strukturës administrative të këshillit të qarkut dhe ka për detyrë të adresojë çështjet sociale brenda territorit të

¹⁴ Informacion më i detajuar për detyrat e secilit prej aktorëve në nivel qarku gjendet në Shtojcën e këtij udhëzuesi

qarkut. Funkcionet kryesore të kësaj njësie janë monitorimi i zbatimit të ligjit dhe politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe raportimi i situatës pranë Këshillit të Qarkut dhe Agjencisë Shtetërore; koordinimi i procesit të referimit të rasteve të abuzimit apo mos-respektimit të drejtave të fëmijëve duke siguruar funksionimin e grupit multi-disiplinar, dhe duke bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe aktorë të shoqërisë civile për në territorin e qarkut.

Grupet Multi-disiplinare

Pranë këshillit të qarkut/bashkisë dhe komunave krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e qarkut. Pjesë e këtyre grupeve multidisiplinare janë punonjësit e njësive për mbrojtjen e fëmijëve në nivel qarku. Është për t'u theksuar se krijimi i grupeve multi-disiplinare në nivel Qarku është një masë e përkohshme deri në krijimin e NjMF-ve në çdo njësi të pushtetit vendor. Në një situatë ku NjMF-të janë ngritur duhet që grupi multi-disiplinar të funksionojë në nivel vendor dhe ky grup drejtohet dhe lehtësohet nga punonjësi i NjMF-së.

Observatori për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve – strukture jo publike.

Zyra e Observatorit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka si qëllim të monitorojë dhe të mbledhë evidenca për situatën e zbatimit të drejtave të fëmijëve në nivel qarku dhe nivel lokal përmes bashkëpunimit me institucionet e ofrimit të shërbimeve, organizatat e shoqërisë civile, agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përmes observimeve të drejtpërdrejta në terren. Mbi bazën e këtyre të dhënave zyra e observatorit prodhon raporte alternative 6-mujore që paraqesin situatën e zbatimit të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut. Pjesë e rolit dhe përgjegjësisë të kësaj zyre është edhe dhënia e kontributit për hartimin e politikave dhe strategjive rajonale për përmirësimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në zonë duke organizuar takime dhe mbledhje me grupe të ndryshme interesi. Duhet theksuar se Observatori për Të Drejtat e Fëmijëve është strukturë e pavarur e shoqërisë civile.

Aktorë në nivel lokal dhe roli i tyre¹⁵:

Skema e mëposhtme paraqet institucionet dhe aktorët kryesorë që kanë një rol në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve në nivel komune/bashkie. Secili prej këtyre aktorëve ka një sërë detyrash dhe përgjegjësish që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, specifikisht përmes ofrimit të shërbimeve përkatëse me cilësi dhe në kohë për të gjithë fëmijët, por sidomos për ata që janë më në rrezik. Përveç detyrave të tyre parësore, këto institucione kanë edhe përgjegjësi që lidhen me bashkëveprimin dhe mbështetjen e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel komune/bashkie.

¹⁵ Një listë e plotë e detyrave të bashkëpunimit të aktorëve në nivel lokal me NjMF-të gjendet në Shtojcën e këtij udhëzuesi




Figure 2 Skema e Aktorëve të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel lokal

VKM e ligjit 10347, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, përcakton detyrimet, rolin dhe përgjegjësitë e secilit prej aktorëve në angazhimet e përbashkëta me NJMF-të për mbrojtjen e fëmijëve.

Disa nga format e bashkëpunimit të këtyre aktorëve me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, bazuar në parimet që udhëheqin punën e kësaj njësie janë:

1. Identifikimi i rasteve të fëmijëve në nevojë dhe referimet përkatëse tek secili aktor sipas nevojave dhe problematikave të fëmijëve;
2. Përfshirja aktive e çdo aktori sipas nevojave në takimet multidisiplinare për diskutimin e rasteve dhe marrja e detyrave sipas përgjegjësisë dhe rolit të gjithësecilit;
3. Kontribut dhe angazhim nga aktorët, sipas profilit të problematikave të fëmijëve, për shoqërimin e PMF-ve gjatë vizitave në familje;
4. Pjesëmarrje në rishqyrtimin e rasteve mbështetur në raportimin e NJMF-së.
5. Pjesëmarrjen në shqyrtimin e mbylljes së rasteve.
6. Detyrimi për ofrimin e shërbimeve i mbështetur në kornizat e ndryshme ligjore dhe mbi të gjitha në VKM nr. 265, dt 12.4.2012.
7. Lehtësim të aksesit në shërbime, ofrim të shërbimeve cilësore dhe miqësore për fëmijët

nën kujdesin e NjMF-së dhe lehtësim i procedurave burokratike për të ofruar shërbime për fëmijët dhe familjet në nevojë.

8. Përfshirja aktive e çdo aktori në tryezat teknike, të cilat mbliidhen për të diskutuar çështje dhe problematika të përgjithshme të fëmijëve dhe familjeve. Rekomandimet e dala nga takimet përkthehen në detyra për çdo aktor dhe në plane dhe iniciativa afatshkutra, afatmesme apo afatgjata;

Pushteti Vendor



Çfarë është Pushteti Vendor dhe si Administrohet?

Pushteti lokal apo ndryshe *qeverisja vendore* përfaqësohet nga njësitë vendore që janë *Bashkia* dhe *Komuna*. Funksionet e bashkive dhe komunave janë të përcaktuara në Ligjin nr.8652, dt. 31.07.2000, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Sipas ligjit këto njësi **kanë kompetenca të plota** administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatore në fushat e mëposhtme¹⁶:

- ✓ Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike:
- ✓ Në fushën e shërbimeve me karakter social, kulturor e sportiv:
- ✓ Në fushën e zhvillimit ekonomik vendor:
- ✓ Në fushën e rendit dhe mbrojtjes civile:

Po ashtu, njësitë të qeverisjes vendore u delegohen funksione apo kompetenca, të cilat mund të jenë të detyrueshme ose jo të detyrueshme. Kompetencat e deleguara, të detyrueshme janë gjithnjë të përcaktuara më ligj dhe insitucionet qendrore përcaktojnë procedurat e kontrollit për zbatimin e tyre. Për kompetenca jo të detyrueshme, bashkëpunimi ndërmjet qeverisjes vendore dhe insitucioneve qendrore realizohet nëpërmjet një marrëveshjeje të posaçme.

Bashkia me nismën e vet mund të përdorë burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara, me synim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit, në interes të bashkësisë.

Gjithashtu, njësitë e qeverisjes vendore kanë edhe disa **funksione të përbashkëta** me pushtetin qendror. Ato e kryejnë secilin nga funksionet e mëposhtme, veçmas ose së bashku me pushtetin qendror, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj. Në rastet kur pushteti qendror i kërkon bashkisë ose komunës kryerjen e një funksioni të përbashkët ose arritjen e një standarti kombëtar për realizimin e këtij funksioni, ai siguron mbështetje të mjaftueshme financiare dhe materiale. Ngritja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve bëhet në kuadër të funksioneve të përbashkëta dhe të deleguara. Bashkia/komuna kryen këto funksione të përbashkëta për këto fusha:

¹⁶ Një listë të detajuar të funksioneve të njësitë të qeverisjes vendore për secilën nga fushat mund ta gjeni në Shtojcën e këtij udhëzuesi.

- a) arsimin parashkollor dhe parauniversitar
- b) sistemin e shërbimit parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik
- c) kujdesin social, zbutjen e varfërisë dhe garantimin e funksionimit të institucioneve përkatëse
- d) rendin publik dhe mbrojtjen civile
- e) mbrojtjen e mjedisit
- f) funksione të tjera të përbashkëta sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.



Financimi i Njësive të Qeverisjes Vendore

Financimi i njësive të qeverisjes vendore bëhet mbi këto parime:

- ✓ Shumëllojshmëria e burimeve të të ardhurave
- ✓ Garantimi me ligj si autoritet për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur
- ✓ Financimi nga të ardhurat që krijohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore; nga fondet e transferuara nga pushteti qendror dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare;
- ✓ Sigurimi i fondeve nga pushteti qendror për përmbushjen e të gjitha standarteve dhe kërkesave për funksionet dhe kompetencat e deleguara
- ✓ Miratimi, zbatimi dhe administrimi i buxhetit vjetor pa defičit në përputhje me ligjin nr. 8379, datë 29.7.1.998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”

Komuna dhe bashkia, krijojnë të ardhura nga taksat dhe tatimet vendore mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël si dhe nga të ardhurat vetjake të krijuara nga dhurata, trashëgimi, teste apo llotari vendore. Gjithashtu ato krijojnë të ardhura edhe nga veprimtaritë e tyre ekonomike si qiratë, shitja e pronave, dhuratat, intersat, gjobat, ndihmat ose donacionet. Në rast nevojë, Bashkia dhe Komuna mund të marrin hua për qëllime publike vendore gjithnjë në përputhje me bazën ligjore.

Perveç të ardhurave vendore, Bashkia dhe Komuna financohen edhe nga burime kombëtare që rrjedhin nga tatimet vetjake dhe tatimet mbi fitimin e subjekteve ekonomike. Këto burime alokohen duke u bazuar tek funksionet e përbashkëta të bashkive dhe komunave dhe jepen nga pushteti qendror në jo më pak se tri transferata në vit.

Pushteti qendror, në bashkëpunim me njësitet vendore analizon mjaftueshmërinë dhe stabilitetin e këtyre burimeve në periudhën e buxhetimit, duke patur parasysh edhe parimin e barazisë së burimeve mes njësive të ndryshme të qeverisjes vendore, në raport me mundësitë e tyre për të krijuar të ardhurat e nevojshme.

Njësitet e qeverisjes vendore kanë autoritet të plotë mbi

Bashkia e Tiranës organizoi takimin konsultativ mbi buxhetin për vitin 2012 për Njësine Administrative nr.4, në 21 Dhjetor 2011. Në takim qenë të pranishëm qytetarë, përfaqesues të institucioneve lokale private dhe publike, punonjës të Njesisë 4, Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në këtë njësi, fëmijë etj. Në takim kryetari i Njesisë Bashkiake nr 4 në bashkinë Tiranë ndau informacionin për planet dhe buxhetet lidhur me infrastrukturën, strehimin, kujdesin social, arsimin parauniversitar dhe edukimin, zhvillimin ekonomik, punësimin, menaxhimin e rrugëve dhe shërbimet publike. Qytetarët, aktorët lokalë dhe fëmijët patën mundësinë të adresojnë problemet dhe nevojat e tyre në këtë takim.

mënyrat e përdorimit të fondeve buxhetore sipas planifikimit vjetor, të miratuar nga Këshilli Bashkiak/Komunal.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë detyrimin ligjor të jenë transparente me qytetarët për buxhetin dhe vendime të tjera që lidhen me qeverisjen vendore, nëpërmjet proceseve të konsultimit me ta. Dhënia e informacionit të nevojshëm i mundëson qytetarëve pjesëmarrjen në vendimmarrje në lidhje me funksionet dhe kompetencat e ushtruara nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse.



Këshilli i Bashkisë/Komunës, Roli dhe Përgjegjësitë e Tij

Shembull:

Këshilli Bashkiak i Tiranës përbëhet nga 55 këshilltarë. Ai ka 14 komisione të paraqitura si më poshtë:

- ✓ Komisioni i Financave (7 anëtarë)
- ✓ Komisioni Juridik (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Ekonomisë dhe Çështjeve Sociale (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Arsimit (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mbrojtjes së Mjedisit (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Shërbimeve Publike (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Rregullimit të Territorit (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Jashtëm (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Mandatave (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Rendit Publik dhe Mbrojtjes civile (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Strehimit (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Kontrollit Financiar (5 anëtarë)
- ✓ Komisioni i Vlerësimit të Figurave të Shquara të Qytetit (7 anëtarë)

Këshilli Bashkiak/Komunal është grupim i këshilltarëve, të cilët janë përfaqësues të forcave politike që me votëbesimin e tyre ndaj projekt-vendimeve të propozuara nga Bashkia/Komuna shprehin dhe mbrojnë interesat e komunitetit që përfaqësojnë. Zgjedhja e kuotave të anëtarëve nga secila forcë politike për t'u bërë pjesë e Këshillit Bashkiak/Komunal, bëhet sipas përqindjes së votave që ka marrë çdo parti në zgjedhjet lokale.

Këshilli Bashkiak dhe Komunal mbledhet jo më pak se një herë në muaj. Kjo mbledhje quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve. Mbledhjet e Këshillit dokumentohen në procesverbale.

Këshilli zgjidhet për një periudhë 3-vjecare dhe përbëhet nga disa komisione, të cilat krijohen në bazë të nevojave që ka çdo Bashki apo Komunë. Pikërisht për këtë arsye numri i komisioneve dhe anëtarëve në çdo Këshill Bashkiak apo Komunal është i ndryshëm.

Funksionet e Këshillit të Bashkisë/Komunës kryhen bazuar në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

Ato përfshijnë kryesisht miratimin e statusit, strukturës, politikave e procedurave institucionale dhe buxhetit të bashkisë/komunës; vendimin për taksat dhe tarifat vendore dhe mbikëqyr

kontrollin e brendshëm të njësisë vendore; mbikëqyr dhe miraton proceset e akt-themelimit të shoqërive të biznesit dhe veprimtarive të tyre brenda territorit të njësisë vendore; vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim tek bashkia, etj. *Një informacion i plotë mbi funksionet e Këshillit Bashkiak/Komunal gjendet në Shtojcën e këtij Udhëzuesi.*

Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të marrë pjesë në këto mbledhje, përveç rasteve kur Këshilli merr vendimin të mbajë mbledhjen me dyer të mbyllura.

Njoftimi për mbledhjen e Këshillit Bashkiak/Komunal bëhet publik në vende të caktuara nga Këshilli dhe në media. Ky njoftim përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Vendimet merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Në raport me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Këshilli Bashkiak/Komunal është institucion i cili shqyrton projekt- vendimet e dala për këtë Njësi nga Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë/Komunës me qëllim trajtimin dhe përmirësimin e çështjeve të lidhura më fëmijët dhe familjet dhe po ashtu buxhetimet e kërkuara për ofrimin e shërbimeve specifike

Këshilli i Bashkisë dhe Komunës ka rol kyc në njohjen e detyrimit që ngre Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve nr. 10347, dhe në miratimin me konsensus dhe pa dallime partiake të këtij shërbimi prej të cilët përfitojnë të gjithë fëmijët.

PJESA II



**Procesi Për Ngritjen e
Njësisë Për Mbrotjen e
Fëmijëve**

Ngritja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve; Një Proces Hap pas Hapi

HAPI I - Aprovimi i strukturës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Këshilli Bashkiak/Komunal

Bazuar në ligjin Nr. 8652, “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, çdo Bashki dhe Komunë harton rregulloren e brendshme të organizmit, detyrave dhe kompetencave të administratës, e cila miratohet nga Këshilli Bashkiak/Komunal¹⁷.

Sipas kësaj rregulloreje, Drejtoria e Ndhmës ekonomike dhe shërbimeve Sociale të Bashkisë apo Komunës, përgatit një material, në formën e një projekt-vendimi për hapjen e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve. Ky projekt-vendim përmban informacion mbi bazën ligjore që mundëson ngritjen e kësaj njësie, rezultate të pilotimit të NJMF-ve në Bashki apo Komuna të tjera, informacion mbi profilin e NJMF-së duke përfshirë rolin, detyrat kryesore të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve, një vlerësim dhe analizë të situatës së fëmijëve në qytetin apo komunën ku do të hapet NJMF-ja, rezultatin e pritshëm nga puna e NJMF-së, një listë të shërbimeve dhe aktiviteteve që priten të ndërmerren nga NJMF-ja dhe mbështetja financiare e nevojshme për këto aktivitete.

Ky material i kalon Drejtorisë Juridike për të vlerësuar bazueshmërinë ligjore dhe pas këtij vlerësimi ai dërgohet për miratim tek Kryetari i Bashkisë apo Komunës nëpërmjet Shefit të Kabinetit të tij/saj. Pasi Kryetari e miraton, ky projekt-vendim i protokolluar, i kalohet Sekretarit të Këshillit Bashkiak/Komunal, i cili e bën atë pjesë të axhendës së mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak/Komunal. Materiali arkivohet, dhe kopje të tij i dërgohen Kryetarit, Nënkryeatrit, Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë/Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social të Bashkisë/Komunës.

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak/Komunal, Drejtori i Shërbimit Social që ka përgatitur projekt-vendimin thërritet të relatojë vetë ose sëbashku me specialistët që kanë dhënë kontribut në përgatitjen e tij. Specialistët mund të jenë edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile mbështetëse. Pas drejtimit të pyetjeve nga anëtarët e Këshillit, merret vendimi për hapjen ose jo të NJMF-së. Kur struktura nuk aprovohet, projekt-vendimi rishqyrtohet në bazë të rekomandimeve dhe risillet me ndryshimet përkatëse në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak/Komunal. Në rastin e aprovimit të saj, fillojnë procedurat për marrjen në punë të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Ndonëse ka praktika të ndryshme në procesin e propozimit dhe miratimit të NjMf-së në nivel vendor është e rëndësishme të ndiqet procesi ligjor i duhur dhe praktika ligjore e bazuar në funksionimin e Ligjit për Pushtetin Vendor. Njëkohësisht duhet theksuar se propozimi për miratim të strukturës së NjMf-së duhet të shoqërohet me koston financiare të shërbimit që do të ofrohet në mënyrë që ky shërbim të buxhetohet plotësisht.

¹⁷ Kjo rregullore merr parasysh dhe bazohet po ashtu edhe në Ligjin e Statusit të Nëpunësit Civil, në Kodin e Punës, në Ligjin Mbi Rregullat e Etikës në Administratën Publike, në Ligjin mbi Urbanistikën, në Ligjin Mbi te Drejtat e Informimit mbi Dokumentat Zyrtarë, Ligjin për Arkivat, VKM për Pranimin në Shërbimin Civil dhe Periudhën e Provës, VKM për Lirimin nga Shërbimi Civil, VKM për Disiplinën në Shërbimin Civil, në Ligjin për Emergjencat Civile, Ligji për Inspektimin e Ndërtimit, për Policinë Bashkiake, VKM për Kohëzgjatjen e Punës dhe Pushimit, etj.

HAPI 2 - Procedurat e Pushtetit Vendor për marrjen në punë të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

FONDACIONI "TERRE DES HOMMES"

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Fondacionin "Terre des hommes" shpall konkurs për vendin e lirë të punës në pozicionin "Specialist i nivelit të lartë (punonjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve)", i cili do të punojë pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social

Baza ligjore e modelimit të detyrave të punonjësit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve:

- > Ligji Nr.9355, datë 10.03.2005 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore", Neni 29, Neni 31 dhe Neni 42.
- > Strategjia Kombëtare e Shërbimeve Shoqërore, MPÇSSH, Dhjetor 2004.
- > Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë dhe "Terre des homes" Misioni, Shqiperi.

Kërkesa të veçanta të kandidatit:

1. Arsimi i lartë në shkencat sociale: punë sociale, sociologji, psikologji
2. Njohuri të një gjuhë të vendeve të BE, anglisht dhe një gjuhë tjetër përbën avantazh.
3. Aftësi në përdorimin e programeve bazë të kompjuterit
4. Kualifikime dhe trajnime në fushën e të drejtave dhe shërbimeve sociale për fëmijët
5. Eksperienca pune me fëmijët
6. Aftësi komunikuese dhe përshtatëse

Detyrat e PMF

1. Identifikimi i fëmijëve nevojë të komunitetit si fëmijë në situatë rruge, fëmijëve viktimë të dhunës fizike e seksuale, fëmijë që punojnë, fëmijë viktimë të trafikimit apo të ekspozuar ndaj këtij fenomeni, fëmijë me një prind, etj
2. Evidentimi i nevojave të fëmijëve vulnerabelë përmes vlerësimit të gjendjes reale social ekonomike të familjeve. Vizitat në familje do të kryen në varesi të shkalles së perqesimit të situatës së fëmijës
3. Hartimi i planeve individuale për çdo fëmijë nevojë duke përcaktuar qartë se si do të mbrohet të drejtat e tij dhe se si ai do të integrohet në jetë normale. Të dhenat e çdo rasti të identifikuar hidhen në dosjen personale të fëmijës. Në të pasqyrohet projekti individual dhe azhromohet ecuria e procesit.
4. Të nxisë bashkëpunimin e ngushtë me familjet e fëmijëve vulnerabelë për të minimizuar shkallën e abuzimit të fëmijëve.
5. Të raportojë në strukturat ndryshe lokale publike rastet e dhunës, abuzimit dhe trafikimit të fëmijëve.
6. Të koordinojë punën e strukturave lokale publike të OJF – ve që operojnë në komunitet për të ndihmuar apo referuar fëmijet në nevojë në shërbimet sociale komunitare
7. Të nxisë mbrojtjen e fëmijëve përmes bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin duke e ndergjegjesuar atë në rolin e tij në mbrojtjen e fëmijëve.
8. Të kontribuojë në hartimin e planeve zonale duke i kushtuar rëndësi edhe planifikimit të nevojave të komunitetit me shërbime në mbrojtjen e fëmijëve.
9. Asiston familjen në pritjen e fëmijëve në një rast KVA ose deportimi. Monitoron procesin e riintegritimit të fëmijës në familje.

Paraqitja e dokumentave:
Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 30.09.2009 në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore këto dokumenta:

1. Kërkesë për aplikim
2. Curriculum Vitae
3. Çertifikatë personale me fotografi dhe çertifikatë familjare.
4. Kopje të noterizuar të diplomës dhe çertifikatës së notave.
5. Çertifikata kualifikimi (nëse ka)
6. Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
7. Kopje të noterizuar të librezës së punës dhe librezës së kontributeve shoqërore.
8. Dëshmi e gjendjes gjyqësore dhe mjekësore.
9. Kopje e noterizuar e dokumentave për master, doktoraturë etj (nëse ka).

Aplikantët që kanë kryer studimet jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave apo çertifikatave.
Dokumentat duhet të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.
Konkurimi do të bazohet në njohuritë për Kushtetutën, Ligjin Nr.9355, datë 10.03.2005 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore", Strategjinë Kombëtare të Shërbimeve Shoqërore.

Procedurat e zbatuara nga pushteti vendor për marrjen në punë të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve janë të njëjta për të gjithë punonjësit e tjerë të Bashkisë/Komunës dhe bazohen në Kodin e Punës, Ligjin për të Drejtën e Punës, i ndryshuar me Ligjin 9125 datë 29.7.2003, specifikisht "pjesa e procedurave administrative për marrjen në punë të nëpunësit civil në administratë".

Sipas këtij ligji, edhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve kategorizohet dhe trajtohet brenda kuadrit ligjor dhe praktik të Nëpunësit Civil¹⁸. Shërbimi civil është i ngritur dhe vepron mbi parimet e profesionalizmit, të integritetit dhe pavarësisë, të paanësisë politike, të transparencës, shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, e të përgjegjësisë dhe korrektësisë së zbatimit të legjislacionit në fuqi. Pikërisht këto

parime udhëheqin në thelb edhe punën e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, si strukturë shërbimesh sociale të Bashkive/Komunave.

Në shërbimin civil pranohen ata persona që plotësojnë disa kërkesa të përgjithshme si; të jenë shtetas shqiptar, të kenë zotësi të plotë për të vepruar, të përmbushin kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës, të jenë në kushtë të mira shëndetësore, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi dhe të mos jenë marrë prej tyre masa disiplinore të largimit nga shërbimi civil për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Ilustrim: I Modeli i njoftimit për shpalljen e konkurimit nga Bashkia Vlorë për hapjen e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në këtë Bashki

Pranimi në shërbimin civil kryhet nëpërmjet konkurimit të hapur bazuar në merita. Në Bashki/Komuna shpallja e konkurimit bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Njoftimi për konkurimin shpallet të paktën 30 ditë nga data e caktuar e konkurimit në dy gazeta të njohura dhe me qarkullimin më të madh në treg.

¹⁸ "Nëpunës Civilë" sipas këtij kodi janë ata nëpunës të institucioneve të administratës të nivelit qëndror apo vendor, të cilët ushtrojnë autoritetin publik në detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse dhe ekzekutuese.

Pushteti vendor mund të përdorë gazetën kryesore lokale, së bashku me një gazetë qendrore për të cilat qytetarët tregojnë interes të lartë.

Publikimi i njoftimit në gazeta siguron një shpërndarje më të gjerë të informacionit dhe rrit mundësitë për përzgjedhjen e një punonjësi civil (*Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve*) që përmbush më mirë kriteret për kualifikimet dhe aftësitë që kërkon pozicioni.

Një informacion i detajuar për kualifikimet dhe aftësitë që kërkon pozicioni i Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve gjendet në Shtojcën e këtij Udhëzuesi.

Personat e interesuar dorëzojnë dokumentat e kërkuara pranë Drejtorisë së Personelit të Bashkisë/Komunës nga ku ka dalë edhe njoftimi.

Konkurimi zhvillohet në tri faza dhe zakonisht drejtohet nga Departamenti i Personelit të njësisë vendore. Në rastet kur ngritja e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve bëhet në bashkëpunim me një organizatë apo aktor tjetër, atëherë kjo organizatë bëhet pjesë e procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve gjatë fazës së parë të procesit të konkurimit, së bashku me përfaqësuesit përkatës të Bashkisë/Komunës ku synohet të ngrihet NJMF-ja dhe të dy palët bien në konsensus për kandidatët të cilët do të kalojnë në fazën e dytë, atë të testimit.

Tri fazat e konkurimit për pozicionin e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve janë si më poshtë:

- ✓ **Në fazën e parë** bëhet përzgjedhja e kandidatëve bazuar mbi dokumentacionin e dorëzuar prej tyre. Në këtë fazë verifikohet nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe vetëm ata që plotësojnë këto kërkesa përzgjidhen për të kaluar në fazën tjetër të konkurimit. Në këtë fazë departamenti i personelit pranë pushtetit lokal, krijon “komitetin *ad-hoc*”, i cili do të vlerësojë kandidatët e përzgjedhur për fazën e dytë të konkurimit. Ky komitet përbëhet nga 5 anëtarë: 1 përfaqësues i Departamentit të Personelit të Bashkisë/Komunës, 1 përfaqësues të Bashkisë/Komunës që kanë kërkuar plotësimin e vendit të ri dhe/ose të lirë dhe 1 profesorë nga fakulteti apo katedra sipas fushës në të cilën do të zhvillohet testimi ose dy specialistë të njohur nga fusha përkatëse¹⁹. Përfshirja e profesionistëve ose specialistëve të fushës sugjerohet për të mbështetur përzgjedhjen e një kandidati me arsimimin e kërkuar në fushën e punës sociale, dhe për të vlerësuar njohuritë dhe përvojën në mënyrë të veçantë të lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, të drejtat e fëmijëve, etj.
- ✓ **Në fazën e dytë bëhet testimi i kandidatëve të përzgjedhur.** Mënyra e testimit vendoset nga komiteti *ad-hoc* dhe zakonisht kryhet *me gojë* dhe *me shkrim* për të gjithë kandidatët e kësaj faze.

Në intervistën me gojë, e cila zgjat 30-35 minuta, merret informacion i përgjithshëm mbi historikun e punësimit të kandidatit, aftësitë e tij/saj, pikat e forta dhe të dobëta, njohuritë e tij/saj mbi çështje të lidhura me të drejtat e fëmijëve etj.

Testimi me shkrim synon më së shumti të identifikojë njohuritë e kandidatëve në nivel praktik dhe aftësitë e tyre të shkruarit. Pyetjet kërkojnë të vlerësojnë nivelin e njohurive dhe të kuptuarin e kandidatëve mbi konceptin e mbrojtjes së fëmijëve; aftësitë e tyre për të identifikuar dhe analizuar aktorët që kanë një rol në mbrojtjen e fëmijëve dhe përvojën e tyre

¹⁹ Këta specialistë mund të jenë edhe përfaqësues të organizatave të cilat mbështesin Bashkinë apo Komunën për ngritjen dhe funksionimin e NJMF-së.

në organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese për mbrojtjen e fëmijëve. Meqënëse këta kandidatë janë kryesisht pjesë e komunitetit, ata testohen edhe mbi kuptueshmërinë dhe sensibilitetin e tyre ndaj problematikave që ekzistojnë në këtë komunitet, të lidhura specifikuisht me fëmijët dhe familjet. *Ju lutem gjeni një guide-tip interviste me gojë dhe një model testimi me shkrim në Shtojcën e këtij Udhëzuesi.*

Pas përfundimit të testimit komiteti ad-hoc bën vlerësimin e secilit prej kandidatëve duke u bazuar tek rezultatet e testimit, të cilat përbëjnë 70% të vlerësimit total dhe tek kualifikimet, përvoja profesionale, aftësitë e veçanta dhe publikime të mundshme, të cilat zënë 30% të vlerësimit total. Ky proces përfundon me përzgjedhjen e 3 kandidatëve me rezultatet më të larta të cilët kalojnë në fazën përfundimtare të konkurimit.

✓ **Faza e vlerësimit përfundimtar.** Në këtë fazë eprori direkt nën varësinë e të cilit ky nëpunës do të punojë (në këtë rast Drejtori i Shërbimit Social të Bashkisë/Komunës) zgjedh kandidatin i cili do të mbajë pozicionin e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve. Zakonisht për këtë zgjedhje Drejtori/Shef i sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social konsultohet edhe me kryetarin e Bashkisë/Komunës, të cilin e njofton paraprakisht mbi kandidatët dhe performancën e tyre në testim, dhe të dy së bashku marrin vendimin përfundimtar. Rezultatet e konkurimit shpallen në 2 gazetat me qarkullim më të madh (zakonisht publikohen aty ku edhe u bë shpallja për konkurim)²⁰.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve merr emërimin zyrtar pas përfundimit të fazës së ankimimit. Ai/ajo qëndron I (një) vit në periudhë prove dhe supervizohet nga Shefi i Sektorit/Drejtori i Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Social. Pas kalimit të periudhës së provës Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve konfirmohet si nëpunës civil. Edhe gjatë fazës së provës ky punonjës i duhet të marrë pjesë në trajnime dhe aktivitete për rritjen e kapaciteteve.

HAPI 3 - Vendosja e pagës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve

Bashkia/Komuna është organi që vendos pagesën e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve bazuar në ligjet dhe vendimet përkatëse²¹. Përcaktimi i pagës bëhet sipas klasifikimit të klasave dhe kategorive për nëpunësit civil²². Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve klasifikohet zakonisht në klasën e katërt të nëpunësit civil.

Paga e nëpunësit civil përbëhet nga: 1. *paga bazë*; 2. *shtesa për pozicionin e vendit të punës*; 3. *shtesa për kushtet e punës* dhe 4. *shtesa për rezultate shumë të mira në punë* mbi bazën e vlerësimit e rezultateve dhe mundësive buxhetore të çdo insitucioni. Kjo shtesë mund të jepet vetëm një herë në vit dhe nuk është pjesë e pagës.

20 Kandidatët që iu nënshtruan testimit kanë të drejtën të bëjnë ankim tek komisioni i shërbimit civil, mbi zhvillimin dhe rezultatet e konkurimit brenda 30 ditëve pune nga botimi i rezultateve. Nëse ankesa rezulton e drejte, ankuesi do t'i propozohet Bashkisë/Komunës për vendin më të parë të lirë, të të njëjtës kategori dhe nivel që ai/ajo ka aplikuar. Në këtë rast Bashkia/Komuna bashkëpunon edhe me shërbimet sociale private dhe e referon kandidatin të punojë në kësi shërbimesh.

21 Vendosja e kufijve maksimalë dhe minimalë të pagesës për Punonjësn e Mbrojtjes së Fëmijëve bazohet tek neni 100 i Kushtetutës, pika 2 e nenit 4 të Ligjit Nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të neneve 24, 32 e 54 të Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

22 Klasat e nëpunësve civil janë katër: I) nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues (sekretari i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor drejtorie të përgjithshme), II) nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues (drejtor drejtorie, pozicione të barasvlefshme me to), III) Nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues (shef sektori, shef zyre, pozicione të barasvlefshme me to) dhe IV) nëpunës civil të nivelit ekzistues (këtu përfshihen specialistët).

Vendosja e *pagës bazë* bazohet në tre komponentë kryesorë: në pagën e grupit, e cila caktohet për nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për kualifikim. Zakonisht Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve kualifikohet si specialist i nivelit të parë apo të dytë bazuar mbi kualifikimet dhe eksperiencën e mëparshme të punës. Kjo do të thotë që pagesa e tij/e saj varion nga 25.500-34.000 lek në muaj.

Sa i përket shtesës për pozicionin e vendit të punës, ajo varion nga numri i banorëve të çdo Bashkie/Komune. Këshilli bashkiak/komunal bazohet në Regjistrin e Gjendjes Civile për të vendosur për shtesat sipas ligjit përkatës. Ndonëse Ligji parashikon një punonjës për NJMF-në, në bashkitë me popullësi të madhe është vënë re se nuk është e mjaftueshme për të përballuar nevojat dhe problematikat lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

HAPI 4 - Një zyrë e përshtatshme dhe funksionale për shërbimet ndaj fëmijëve

Zakonisht zyra e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve ndodhet brenda institucionit të Bashkisë/Komunës. Në rastet kur institucioni nuk ka ambjente të mjaftueshme, ajo mund të vendoset së bashku me gjithë sektorët e tjerë të Shërbimit Social të Bashkisë/Komunës në një ambient tjetër, pronë e qëndrueshme apo e përkohshme e Bashkisë/Komunës.

Është e nevojshme që zyra e NJMF-së të ketë të gjitha kushtet e përshtatshme për zbatimin e funksioneve të saj. Rekomandohet që ajo të ketë një ambient të vetin, te vecuar nga zyrat e sektorëve të tjerë meqenëse Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve ka nevojën, detyrën dhe përgjegjësinë të këshillojë fëmijën dhe familjen duke ruajtur konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës.

Kjo zyrë duhet të jetë e pajisur me të gjitha orëditë dhe pajisjet e domosdoshme të punës së një Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve (*një tavolinë, 3-4 karrige, kompjuter, printer/fotokopje, linjë telefoni dhe internet, një tabelë për ngjitjen e dokumenteve apo promovimin e aktiviteteve të NJMF dhe një raft me çelës për mbajtjen e dosjeve të fëmijëve*). Për t'ju përmbajtur parimit të konfidencialitetit kompjuteri i PMF-së duhet të jetë personal dhe të mos përdoret nga të tjerët (përveç ndonjë personi të autorizuar nga ky punonjës) meqenëse aty depozitohen të dhënat e fëmijëve. Kostoja e këtyre objekteve llogaritet vetëm për një vit (përveç bojës së printerit). Kostot mujore janë kryesisht për mjete zyre si (letër e bardhë, dosje A4, stilolapsa etj).

HAPI 5 - Prezantimi publik i Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve

Prezantimi i NJMF-së është një hap i rëndësishëm që Bashkia/Komuna duhet ndërmarrë për të vënë në dijeni aktorët kyç dhe komunitetin e gjerë, fëmijët dhe familjet rreth funksionit të saj si shërbim social në mbrojtje të fëmijëve. Ky prezantim i paraprin kontakteve direkte që Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet më pas të realizojë me çdonjërin prej aktorëve kyç për mbrojtjen e fëmijëve. Prezantimi fillon me njohjen e punonjësit të NJMF-së me personelin e bashkisë/ komunës ku do të punojë dhe njohja me rolet dhe detyrat e gjithësecilit.

Si rregull prezantimi bëhet në formën e një aktiviteti ku ftohen të marrin pjesë aktorë kyç në nivel lokal, rajonal dhe qendror si dhe përfaqësues të komunitetit, prindër dhe fëmijë. Aktiviteti dhe hapja e NJMF-së promovohet edhe në media përmes një komunikate për shtyp, e cila përmban informacion të detajuar mbi strukturën dhe funksionet e saj, si dhe personat e kontaktit. Gjatë aktivitetit, Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve prezanton në mënyrë më të hollësishme detyrat e njesisë, rolit dhe funksioneve të saj dhe u drejton mesazhe aktorëve për

një angazhim të përbashkët për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu është e rëndësishme që punonjësi të ketë një numër telefoni të zyrës dhe të informojë në mënyrë të vazhdueshme për këtë numër. Në këtë mënyrë qytetarët dhe strukturat e ndryshme mund të referojnë drejtpërdrejt përmes telefonit.

Për një informacion më të detajuar mbi hapat për organizimin dhe zhvillimin e prezantimit të NJMF-së, ju lutem referojuni Shtojcës së këtij Udhëzuesi.



Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Buxhetimi për më tepër vëmendje ndaj Fëmijëve

Një nga sfidat thelbësore për funksionimin e një NJMF-je është mungesa e burimeve financiare. Në studimin e NJMF-ve, Janar 2013¹, të gjitha NJMF-të e intervistuar në studim sjellin mungesën e një buxheti të vecantë për këtë shërbim dhe specifikat që kërkon.

Ligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” nëntor 2010, thekson nevojën e hapjes së NJMFve në të gjithë territorin e Shqipërisë, por nuk specifikon mënyrën se si ato duhen financuar dhe afatet për të ngritur këtë shërbim. Po ashtu, nuk parashikohen zëra të vecantë pa të cilat ky shërbim nuk mund të jetë funksional dhe brenda standarteve të funksionimit normal, si psh: zë buxheti për mbeshtetjen e familjeve në rrezik, zë për trajtimin e rasteve në rrezik ose emergjente, zë për transport dhe vizita në familje për ndjekjen e rasteve dhe familjeve, zë për aktivitete apo publikime ndërgjegjësuese etj.

Mungesa e buxhetit gjithashtu ndikon në mënyrën sesi punonjësi i MF-ve dhe pushteti vendor janë në gjendje për të mbështetur familjet. Gjithashtu studimi i NJMFve thekson se mungesa e parashikimit të një buxheti ndikon që shërbimi të mbështetet në shërbimet dhe burimet ekzistuese të cilat shpesh herë janë të kufizuara ose nuk arrijnë të adresojnë nevojat komplekse të një fëmije të abuzuar apo familje në rrezik. Kjo nuk është në përputhje as me praktikën e mirë të ndërtuar tashmë në disa Bashki ku ka filluar parashikimi i buxhetit për shërbimin e mbrojtjes së fëmijëve, as me synimet e Protokollit të MF, i cili kërkon ndërhyrje që bazohen te nevojat e rastit të identifikuar, madje shkon dhe më tej në parandalimin e abuzimit ndaj fëmijëve.

Komunat apo Bashkitë, cdo vit rishikojnë dhe planifikojnë buxhetin e tyre. Viti buxhetor është i njëjtë me vitin kalendarik. Viti buxhetor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik². NJMF-të dhe shërbimet që ato ofrojnë janë pjesë e shërbimeve me karkater social të Komunave apo Bashkive, dhe si të tilla janë të legjitimuara të kenë pjesë në buxhetimin e komunës apo bashkisë, jo si një përjashtim apo alternativë por si një detyrim ligjor i pushtetit vendor në sigurimin e shërbimit social e mbrojtjes për fëmijët- qytetarë në territorin e tyre.

Ministria e Financave, mbështetur në vendimet e nxjerra nga Këshilli i Ministrave, brenda datës 10 korrik të çdo viti buxhetor nxjerr udhëzimin për përgatitjen e projektbuxhetit nga të gjitha institucionet buxhetore³. Çdo bashki apo Komune në bazë të këtij udhëzimi përgatit buxhetin dhe e paraqet për miratim pranë Ministrisë së Financave brenda datës 1 Shtator.

¹ WV Evaluation Study on Child Protection Units, S.Delaney, January 2013

² Neni 3LIGJIT NR. 8652, DATË 31.07.2000, “Për Organizimin Dhe Funksionimin E Qeverisjes Vendore”

Kjo është një periudhë kyce për t'u përfshirë dhe advokuar në nivel lokal për përfshirjen dhe rritjen e buxhetit për mbrojtjen dhe mirëqënien e fëmijëve.

Vetë NJMF-të dhe drejtuesit e shërbimeve sociale duhet të luajnë një rol proaktiv të rëndësishëm duke:

- *Pergatitur propozime bazuar në evidencat e punës së përditshme për nevojën e këtij shërbimi si nga pikëpamja ligjore ashtu edhe nisur nga situata aktuale në zonën e tyre, duke paraqitur dokumentacion mbi numrin e rasteve të identifikuara dhe trajtuara, nevojat specifike të fëmijëve dhe familjeve të ndryshme, mungesën e shërbimeve etj.*
- *Duke influencuar anëtarët e Këshillit bashkiak/komunal si organ vendimmarrës për miratimin dhe ndryshimet e buxhetit në menyrë të tillë që mbrojtja e fëmijëve të marrë një vend specifik në buxhet.*
- *Hartimin e zërave të buxhetit për shërbimin e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve duke qenë njohësit më të mirë të shërbimit dhe nevojave të strukturës së NJMFsë.*
- *Mobilizimin e anëtarëve të komunitetit për të advokuar në një proces buxhetimi me pjesëmarrje për më shumë fonde për mbrojtjen e fëmijëve*


Buxhetimi me pjesëmarrje.

Buxhetimi me pjesëmarrje (BP) është një trajtim i ri që sjell komunitetet lokale më afër procesit të vendimmarrjes lidhur me buxhetin publik. Mund të jetë një prej përjasjeve të përdorura për të përfocuar zërin advokues.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët, përfaqësues të shoqërisë civile dhe lokale, komunitetet, bizneset të jenë pjesë në vendimmarrjen për menaxhimin e burimeve aktive të financave publike të pushtetit lokal. Proçesi i pjesëmarrjes është mbi baza vullnetare dhe duhet të sigurojë që grupet e marginalizuara (zakonisht qytetarë me të ardhura të ulëta, gra, të rinj, fëmijë dhe emigrantë) të jenë të përfshirë direkt në të gjitha fazat konsultuese. Ky proces sjell rritje të efektivitetit në targetimin e buxhetit, përmirëson transparencën dhe përgjegjshmërisë si dhe nxit përfshirjen sociale, zvogëlimin e varfërisë dhe fuqizimin e komunitetit.

Më poshtë është ilustruar në mënyrë skematike cikli i miratimit të buxhetit dhe se ku mund të influencohet proçesi i buxhetimit për mbrojtjen e fëmijëve.

3 Neni 15 LIGJIT NR. 8652, DATË 31.07.2000, "Për Organizimin Dhe Funkzionimin E Qeverisjes Vendore"



Njëkohësisht ia vlen të përmendet që, përpjekje duhen bërë për të advokuar në nivel kombëtar për alokimin e një buxheti më të madh për shërbimet për fëmijët në të gjithë Shqipërinë. Adresimi i mbrojtjes dhe promovimi i mirëqënies së fëmijëve në rrezik përmes ofrimit të më shumë shërbimeve sociale për mbrojtjen e tyre është jo vetëm një detyrim i pushtetit lokal por njëkohësisht dhe i nivelit qendror prandaj ende mbetet për të maksimizuar përpjekjet për të rritur vëmendjen, burimet, kapacitetet dhe shërbimet në të gjitha nivelet.

Modele të Bashkëpunimit për Ngritjen dhe Zhvillimin e NJMF-ve

Duke qenë se ngritja dhe funksionimi i strukturës së NJMF-ve ka kaluar nëpër një fazë jo të shkurtër pilotimi, janë zhvilluar dhe përdorur disa modele bashkëpunimi midis Bashkisë/ Komunes dhe organizatave mbështetëse për funksionimin e tyre. Këto modele japin një tablo disi më të qartë për nevojat që ka NJMF-ja për të kryer funksionet e saj më mire dhe përfshijnë detajimin e planeve të aktiviteteve dhe parashikimin e buxhetit përkatës, si dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Marrëveshja e Bashkëpunimit nënshkruhet mes Bashkisë/Komunës dhe organizatës mbështetëse dhe përcakton detyrimet dhe përgjegjësitë që secila palë ka në bashkëpunimin për ngritjen dhe mbështetjen e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve. Ajo përmban një plan të detajuar aktivitetesh që do të ndërmerren dhe se si këto aktivitete do të mbështeten teknikisht dhe financiarisht.

Aktivitetet kryesore të NJMF-së përfshijnë kryesisht:

- ✓ Vlerësimin dhe manaxhimin e rasteve të identifikuara/ referuara në bashkëpunim me grupin multi-disiplinar;
- ✓ **asistencë direkte** për fëmijën dhe familjen (ushqime, veshje, materiale higjienike, qera shtëpie, transport, procedura ligjore, kurse profesionale, etj);
- ✓ **vizita në familje dhe mbështetje për ndjekien e shkollës** (pajisje me libra, fletore, mjete kancelarike etj);
- ✓ **mbështetje e fëmijëve dhe familjeve me informim, edukim dhe këshillim të vazhdueshëm për mbarëvajtjen e përkujdesit ndaj fëmijëve.**
- ✓ **aktiviteteve ndërgjegjësuere, parandaluese, edukative, promovuese** për mbrojtjen e fëmijëve shoqëruar me përgatitjen e materialeve informuese promovuese;
- ✓ **organizimin e tryezave teknike në nivel bashkie/komune për çështjet shqetësuese të mbrojtjes së fëmijëve në zonën ku operon;**
- ✓ **organizimin e kampit veror në bashkëpunim me partnerë të tjerë.**
- ✓ **hedhjen e të dhenave në sistemin elektronik, si dhe përdorimi dhe mirëmbajtja e tij**
- ✓ hartimin e raporteve statistikore dhe përshkruese për progresin e punës, etj.

Të gjitha këto aktivitete kanë kostot e tyre që duhet vlerësuar dhe parashikuar në buxhetimet vjetore të Bashkisë/Komunës për NJMF-të, duke i parë në raport me burimet e tjera si ndihma ekonomike, fondi social etj.

Rritja e Kapaciteteve të Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunëtorëve të Tyre

Zbatimi i ligjit si dhe ngritja e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve është një proces dinamik dhe në zhvillim. Është e rëndësishme që paralelisht me ngritjen e këtij shërbimi të mbështetet dhe orientimi, trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të punonjësve të NJMF-ve, drejtuesve të shërbimeve sociale si dhe shërbim ofruesve të cilët kanë përgjegjësi të drejtpërdrejt në mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit dhe dhunës.

Rritja e kapaciteteve të Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe supervizimi i tyre teknik në vazhdimësi është shumë i rëndësishëm për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunitet. Mbështetja teknike e PMF-

ve bëhet duke siguruar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete trajnuese, studimore e shkëmbime eksperiencash. Duhet theksuar se është mjaft e rëndësishme që punonjësi i NjMF-së të mbështetet në vazhdimësi pasi puna në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe adresimit të problemeve në mënyrë efektive është mjaft komplekse, e vështirë, me shumë dilema, pasiguri dhe stres emocional, etj.



Paketa e Trajnimit Orientues Bazë për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve

Bazuar në eksperiencën e deritanishme të punës së PMF-ve dhe në çështjet më të hasura që lidhen me situatën e fëmijëve dhe familjeve në komunitet, u hartua edhe një pakete trajnimi orientuese bazë për ata dhe bashkëpunëtorët kyç të tyre. Në thelb kjo paketë trajnimi hedh bazat e formimit parësor për një PMF, pavarësisht formimit profesional dhe eksperiencës së mëparshme të punës me fëmijët dhe familjet. Çështjet e përfshira në paketën e trajnimit bazë, trajtohen në nivel teorik dhe praktik dhe shumë prej tyre zhvillohen duke përdorur metodologjinë “mësimi nëpërmjet punës”.

Të gjithë PMF-të duhet të përfitojnë nga paketa e trajnimit parësor nëpërmjet marrjes së trajnimeve të ofruara nga aktorë qëndrorë, lokalë apo aktorë të shoqërisë civile sipas udhëzimeve apo rregulloreve të institucioneve përkatëse. Paketa e trajnimit bazë përmban një seri temash që përbëjnë thelbin e parimeve të punës dhe praktikës së PMF-ve. Kjo paketë është e organizuar në formën e një kurrikulumi ku secila temë përbën një modul dhe trajton një sërë çështjesh të lidhura me tëmen përkatëse.

Si pjesë e këtij orientimi është parashikuar dhe shkëmbimi i përvojës me punonjës të NjMF-ve me përvojë; ndjekja e një takimi multidisiplinar, ndarja e përvojave nga ana e një grupi multidisiplinar me përvojë, diskutimi i një rasti hap pas hapi duke evidentuar çështjet kyce gjatë procesit të vlerësimit dhe analizës së informacionit, vlerësimin e rrezikut, përjasjet e përdorura deri në momentin e mbylljes së rastit. Gjithashtu, si pjesë e orientimit në vazhdimësi, përfshihet dhe njohja nga afër e praktikës së qendrave ditore, komunitare dhe e programeve me fokus fëmijët në nevojë të ofruara si nga institucionet publike dhe ato jo-publike.

Ky orientim mund të ofrohet përgjatë një periudhe kohore 15 ditore ose mund të shtrihet në kohë sipas nevojave dhe mundësive të PNjMF. Njëkohësisht, ky plan mund të përshtatet duke marrë në konsideratë kapacitetet dhe përvojën e punonjësit. Pas një periudhe 6-mujore bashkë me punonjës dhe supervizorin e NjMF-së, organizohet një takim reflektues për të diskutuar progresin, arritjet dhe sfidat në punë, si dhe për të evidentuar çështje të cilat duhet të trajtohen në vazhdimësi.

Informacioni i plotë dhe tabela me të dhëna të detajuara për temat dhe çështjet për çdo temë gjendet në Shtojcën e këtij Udhëzuesi.



Moduli i Trajnimit për Aktorët e Mbrojtjes së Fëmijëve

Materialet e trajnimit janë hartuar kryesisht për rritjen e kapaciteteve të Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve. Megjithatë është parashikuar, që këto materiale mund të përdoren, për të mbështetur zhvillimin e aftësive edhe të punonjësve të tjerë, puna e të cilëve lidhet me mbrojtjen dhe mirëqënien e fëmijëve, si psh: punonjësit e OJF-ve, të Institucioneve Rezidenciale, të qendrave ditore ose komunitare për fëmijët, të arsimit, shëndetësisë, sistemit të drejtësisë etj, si dhe të drejtuesve të shërbimeve sociale.

Një Komitet Drejtues, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Social Shtetëror, Fakulteti i Shkencave Sociale (Departamenti i Punës Sociale dhe Politikave Sociale), Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, UNICEF dhe Terre des hommes kanë qenë përgjegjës për miratimin përfundimtar të çdo moduli. Ky Komitet, gjithashtu miratoi skicën fillestare dhe përmbajtjen e Kurrikulës.

Kjo nismë është ndërmarrë edhe në kuadër të Strategjisë për Reformën e Shërbimeve Sociale, mbështetet në Platformën e Trajnimeve për Ofruesit e Shërbimeve sociale si dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, i cili ndërmjet të tjerash citon angazhimin për ngritjen e kapaciteteve të Punonjësve të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve në njësitë e qeverisjes vendore.

Ky modul trajnimesh do të jetë jo vetëm për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, por edhe për supervisorët e tyre, për personelin e sektorëve të tjerë të përfshirë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, të tillë si shëndeti publik, administratorë të mbrojtjes sociale, struktura të ligjit dhe të fushës së edukimit dhe arsimimit. Ai përmban edhe çështje të paketës bazë të trajnimit për PMF-të, por gjithsesi është shumë më i gjërë si në çështje ashtu edhe në kategoritë e aktorëve të cilët do të përfitojnë.

Një listë e detajuar me çështjet kryesore me temat specifike të këtij moduli gjendet në Shtojcën e këtij Udhëzuesi.

SHTOJCA



Shtojca I- Detyrat dhe Përgjegjësitë e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve

Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve ka një sërë detyrash dhe përgjegjësisish të përcaktuara në Ligjin 10347, Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në praktikën e rolit dhe funksionit të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, PMF-ve ka për detyrë të:

- Të identifikojë, vlerësojë dhe koordinojë veprimet dhe shërbimet me synim mbrojtjen e fëmijëve në rrezik brenda territorit të Bashkisë/Komunës. Mbrojtja e fëmijëve nga neglizhimi, abuzimi, dhuna, shfrytëzimi, përjashtimi social, trafikimi, si dhe nga fenomene të tjera që çënojnë mirëqenien e tyre, në bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të ngushtë me personelin e Bashkisë/Komunës, partnerët lokalë që veprojnë në zonë, si dhe me të gjithë aktorët e tjerë të cilët kanë rol dhe përgjegjësi në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Të kryejë vlerësimin fillestar të fëmijëve të referuar si në rrezik apo në nevojë, të hartojë planin e ndërhyrjes, të menaxhojë rastin dhe ta ndjekë atë në bashkëpunim me aktorët përkatës të mbledhur në takimin për mbrojtjen e fëmijëve;
- Të bashkëpunojë dhe koordinojë me të gjitha strukturat brenda zyrës së Shërbimit Social në Bashki/Komunë dhe aktorë të tjerë publikë dhe jo publikë, me qëllim përmirësimin e situatës së fëmijëve dhe të familjeve të tyre, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të rrjetit mbrojtës dhe shërbimeve të komunitetit.
- Të ndërtojë dhe thërrasë rregullisht, i mbështetur nga Supervizori (Drejtori i Shërbimit Social) i tij/e saj, ekipin multidisiplinar për të adresuar dhe koordinuar ndërhyrjen për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.
- Të konsultohet dhe këshillohet rregullisht me supervizorin për të përcaktuar nivelin e rrezikut për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, konsultimin për planin e ndërhyrjes, si dhe zbatimin e plotë të këtij plani ndërhyrjeje.
- Të bashkëpunojë me shërbimet sociale pranë Bashkisë, Shërbimin Social Rajonal, si dhe me shërbimet sociale të shpërndara në territorin e Bashkisë/Komunës, për të siguruar referimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë për shërbime sociale në shërbime të specializuara apo që nuk ofrohen në zonë.
- Të sigurojë dokumentimin e të dhënave të sakta e faktike dhe dosje personale për të gjithë fëmijët e identifikuar dhe referuar pranë NJMF-së, (sipas formatit të Protokollit të Punës të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bazës së të dhënave elektronike).
- Të evidentojë çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në njësinë vendore dhe t'i ndajë ato rregullisht me supervizorin dhe aktorë të tjerë lokalë.
- Të raportojë pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve.
- Të organizojë në bashkëpunim me aktorë të tjerë, aktivitete ndërgjegjësuese në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Të marrë pjesë aktive në programet e trajnimeve të ofruara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe të zhvillojë kompetencat psikosociale dhe metodologjike në punën me fëmijët.
- Të adresojë, advokojë dhe llobojë në nivel institucional lokal dhe rajonal për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Të kontribuojë me ide, të dhëna dhe propozime në aktivitetet për hartimin e Strategjisë së Shërbimeve Sociale për Bashkinë/Komunën apo strategjive të tjera sipas nevojës.
- Të promovojë çështjet që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve parandaluese, sensibilizuese, edukative.

Shtojca 2 - Detyrat, FunkSIONet dhe Format e Bashkëpunimit të Aktorëve Kyç për Mbrojtjen e Fëmijëve

I. Detyrat kryesore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve janë:

- a) Të monitorojë dhe të kontrollojë zbatimin e Ligjit 10347, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, të Strategjisë Kombëtare e të Planit të Veprimit të saj, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të legjislacionit në fuqi në këtë fushë;
- b) T’i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;
- c) Të përgatisë dhe t’i propozojë ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijëve udhëzime metodologjike për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në organet e qeverisjes vendore;
- d) Të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Europian në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- e) T’i japë mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- f) Të bashkërendojë punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së fëmijës;
- g) Të organizojë dhe të bashkërendojë kërkimet shkencore dhe veprimtaritë informuese në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- h) Të ndërtojë dhe të realizojë veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit gjyqësor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera;
- i) Të ndërtojë mekanizmat e mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe të mbikëqyrë mbledhjen dhe përpunimin e tyre;
- j) Të unifikojë të dhënat statistikore për çështjet që lidhen me fëmijët, në bashkëpunim me mekanizmat institucionalë në nivel vendor për mbledhjen dhe përpunimin e përgjithshëm të tyre;
- k) Të realizojë mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informacionit për promovimin e respektimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- l) T’i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- m) Të zhvillojë dhe të mirëmbajë sistemin e informacionit për:
 1. institucionet e specializuara për fëmijët dhe personat e kontaktit;
 2. organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

- 3. të dhëna të tjera që lidhen me mbrojtjen e fëmijës;
- n) Të koordinojë burimet e ndryshme të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve;
- o) Të vendosë gjobë ndaj shkelësve të ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 40 të këtij ligji.
- p) Të bashkërendojë veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera.

2. Detyrat e Njesisë për të Drejtat e Fëmijës në Këshillin e Qarkut

Njësia për të Drejtat e Fëmijës, që funksionon brenda strukturës administrative të këshillit të qarkut, ka për detyrë:

- a) Të monitorojë dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;
- b) Të identifikojë dhe të koordinojë referimin e rasteve të shkeljeve apo të abuzimit, të keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut;
- c) Të koordinojë funksionimin e grupit multidisiplinar, për identifikimin, analizën dhe referimin e rasteve të dhunës në familje në territorin e qarkut;
- d) Të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacionin për trajtimin e të drejtave të fëmijës me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të qeverisjes vendore, në bashki dhe komuna, apo të shoqërisë civile;
- e) Të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për të drejtat e fëmijës në qark;
- f) T'i raportojë këshillit të qarkut për ecurinë e respektimit të të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;
- g) T'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të dhënat statistikore që ka përpunuar, për situatën e të drejtave të fëmijëve në qark;
- h) Pranë këshillit të qarkut të krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e qarkut. Pjesë e këtyre grupeve multidisiplinare janë edhe Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve.

3. Grupi Teknik Multi disiplinuar dhe Funksionimi

Grupi teknik multidisiplinar është një grup “*ad hoc*”, i cili funksionon pranë bashkisë/komunës, thirret në bazë të vlerësimit fillestar, drejtohet nga drejtori/përgjegjësi i shërbimeve sociale në bashki/komunë dhe ka në përbërje:

- a. Punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë;
- b. Përfaqësuesin e strukturës së policisë;
- c. Përfaqësuesin e Shërbimit Social Rajonal;
- d. Përfaqësuesin e Drejtorisë Arsimore Rajonale;
- e. Administratorin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore të bashkisë/komunës ku jeton fëmija;
- f. Prindërit / kujdestarët ligjorë/përfaqësuesit ligjorë të fëmijës ose anëtarët e familjes;
- g. Edukatorin e kopshtit ose mësuesin/en e shkollës së fëmijës;
- h. Koordinatorin e psikologëve të DAR-së, psikologun e shkollës;
- i. Specialistët e shëndetit, mjekun e familjes apo një specialist që ka vizituar apo vlerësuar fëmijën;
- j. Koordinatorin për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare në bashki/administratorin shoqëror të ngarkuar për çështjet e dhunës në komunë;

- k. Çdo specialist që njeh fëmijën ose që mund të flasë për një problem që është shqetësues për fëmijën (avokat, psikolog, punonjës social, specialistë që ofrojnë shërbime të specializuara lidhur me zhvillimin e fëmijës, etj.);
- l. OJF-të që ofrojnë shërbime për fëmijën, ofrues publikë, privatë të shërbimeve sociale;
- m. Fëmijën, bazuar në moshën dhe shkallën e pjekurisë dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij.

Në takimet e grupit teknik multidisiplinar ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve të drejtësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut, ku bën pjesë edhe bashkia/komuna, si dhe persona ose institucione, pjesëmarrja e të cilave gjykohet si e domosdoshme për menaxhimin e rastit.

Në takimet e grupit teknik multidisiplinar thirren të marrin pjesë anëtarët e nevojshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik.

Grupi teknik multidisiplinar ka për detyrë:

- a. të shqyrtojë dhe të vlerësojë propozimet e njësisë për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në vlerësimin fillestar të kryer nga kjo njësi;
- b. të analizojë situatën duke diskutuar për mënyrat e ndërhyrjes;
- c. të diskutojë dhe të miratojë planin individual për mbrojtjen e fëmijës, duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës;
- d. të sigurojë ofrimin dhe koordinimin e shërbimeve në bazë të planit individual për mbrojtjen e fëmijës;
- e. të mbledhet në mënyrë periodike dhe të rishikojë planin individual për mbrojtjen e fëmijës, duke iu përshtatur nevojave në ndryshim, sipas fëmijës dhe familjes;
- f. të miratojë mbylljen e rastit kur vlerëson që fëmija nuk është në rrezik.

4. Detyrat e Specialistit të Observatorit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

- a) Specialisti vendos marrëdhënie institucionale bashkëpunimi me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve publike dhe jopublike në nivel rajonal.
- b) Mbledh periodikisht të dhëna nga institucionet shëndetësore, arsimore, të mbrojtjes sociale, zyrës së mbrojtjes të fëmijëve, OJF-ve në nivel lokal dhe rajonal.
- c) Përgatit dhe shpërndan raporte 6-mujore (sipas modelit kombëtar), bazuar mbi informacionin dhe të dhënat e mbledhura për periudhën përkatëse.
- d) Përgatit raportin vjetor mbi progresin e zbatimit të politikave dhe treguesve për realizimin e të drejtave të fëmijëve në rajonet përkatëse.
- e) Mbledh periodikisht raporte dhe materiale të prodhuara nga agjensi të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare.
- f) Kryen punët administrative për funksionimin e zyrës së Observatorit në nivel qarku.
- g) Mbështet punën e grupeve, të konsulentëve dhe aktorëve në nivel lokal dhe rajonal për të orientuar dhe ndihmuar në hartimin e politikave dhe strategjive zonale në përmbushje dhe respektim të të drejtave të fëmijëve, duke organizuar takime dhe mbledhje me grupe të ndryshme interesi.
- h) Mirëmban dhe përditëson rregullisht sistemin elektronik të të dhënave me informacione të mbledhura nga institucionet lokale dhe përdor materialet e mbledhura në përgatitjen e raporteve
- i) Merr pjesë aktivisht në të gjithë aktivitetet e organizuara në nivel lokal, rajonal që kanë të

bëjnë me të drejtat e fëmijëve.

- j) Përgatit dhe shpërndan materiale ndërgjegjësuese në publik lidhur me të drejtat e fëmijëve.
- k) Organizon dhe kryen observime, vrojtme, intervistime me fokus grupe të ndryshme (fëmijë, prindër, mësues dhe drejtorë shkolle, drejtues dhe ekspertë vendorë dhe profesionistë të ndryshëm), për të nxjerrë konkluzione lidhur me zbatimin e të drejtave të fëmijëve.
- l) Specialisti bashkëpunon ngushtë dhe organizon aktivitete të ndryshme me fokus “Të drejtat e fëmijëve” me zyrat e Aleancës për Fëmijët në Shqipëri, në qarqet përkatëse.
- m) Mbledh dhe arkivon raste / ngjarje / fakte nga terreni, të cilat ilustron zbatimin apo mos zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

5. Format e Bashkëpunimit të Aktorëve në Nivel Lokal me NjMF-në

Disa nga mënyrat dhe llojet bashkëpunimit aktorëve kyç me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve konsistojnë në:

- a) Identifikimi i rasteve të fëmijëve në nevojë dhe referimet përkatëse tek secili aktor sipas nevojave dhe problematikave të fëmijëve;
- b) Përfshirja aktive dhe proaktive e çdo aktori sipas nevojave në takimet multidisiplinare për diskutimin e rasteve dhe marrja e detyrave sipas përgjegjësisë dhe rolit të gjithësecilit;
- c) Kontribut nga aktorët, sipas profilit të problematikave të fëmijëve, për shoqërimin e PMF-ve gjatë vizitave në familje;
- d) Përfshirja aktive dhe proaktive e çdo aktori në tryezat teknike, të cilat mbledhen për të diskutuar çështje dhe problematika të përgjithshme të fëmijëve dhe familjeve. Rekomandimet e dala nga takimet përkthehen në detyra për çdo aktor dhe në plane dhe iniciativa afatshkutra, afatmesme apo afatgjata;
- e) Çdo aktor, individualisht brenda institucionit të tij diskuton, mbi baza të forta të ruajtjes së privatësisë, problematika apo çështje specifike që kanë lidhje me fëmijët e zonës, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve apo zhvillimin e praktikave funksionale për t'i ndarë me PMF dhe aktorët e saj;
- f) Ndarja e eksperiencave dhe praktikave të mira ndër-institucionale në mbështetje të mbrojtjes së fëmijëve;
- g) Çdo aktor informon dhe njofton njëri-tjetrin lidhur me ligjet, VKM-të, dispozitat, rregulloret dhe ndryshimet e tyre sipas fushave përkatëse ku janë të punësuar;
- h) Bashkëpunim dhe mbështetje teknike dhe financiare për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve parandaluese, ndërgjegjësuese dhe edukative për fëmijët dhe komunitetin;
- i) Aktorët ndihmojnë PMF-të në kryerjen e vlerësimit dhe analizës së situatës së fëmijëve të zonës;
- j) Aktorët japin kontribut në hartimin e planit social të zonës me fokus ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve;
- k) Aktorët japin kontribut nëpërmjet qëndrimit advokues ndaj projekt vendimeve dhe çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve

Shtojca 3 - Pushteti Vendor dhe FunkSIONET E Njësive të Qeverisjes Vendore

I. FunkSIONET E Njësive të Qeverisjes Vendore

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike:

- a) Furnizimi me ujë të pijshëm
- b) FunkSIONIMI i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza dhe kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara
- c) Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike
- d) Ndriçimi i mjediseve publike
- e) FunkSIONIMI i transportit publik urban
- f) Administrimi i varrezave dhe garantimi i shërbimit të varrimit
- g) Shërbimi i dekorit
- h) Administrimi i parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike
- i) Grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave
- j) Planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi sipas mënyrës së përcaktuar me ligj

2. Në fushën e shërbimeve me karakter social, kulturor e sportiv:

- a) Ruajtja dhe zhvillimi i vlerave kulturore dhe historike vendore, organizimi i veprimtarive dhe administrimi i institucioneve përkatëse
- b) Organizimi i veprimtarive sportive, çlodhëse e argëtuese dhe administrimi i institucioneve përkatëse
- c) Shërbimi social dhe administrimi i institucioneve si: çerdhet, azilet, shtëpitë e fëmijëve, etj.

3. Në fushën e zhvillimit ekonomik vendor:

- a) Përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor
- b) Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- c) Zhvillimi i biznesit të vogël, si dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse si panairë e reklama në vende publike
- d) Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si: informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme
- e) Shërbimi veterinar
- f) Ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave e burimeve natyrore me karakter vendor

4. Në fushën e rendit dhe mbrojtjes civile:

- a) Ruajtja e rendit publik për parandalimin e shkeljeve administrative dhe garantimi i zbatimit të akteve të Bashkisë
- b) Mbrojtja civile

5. Kompetencat e Këshillit Bashkiak dhe Komunal

Mbështetur në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, disa nga detyrat dhe kompetencat më kryesore të Këshillit të Bashkisë/Komunës janë:

- a) Miraton statutin e bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.
- b) Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë, të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve dhe të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- c) Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose është bashkëthemelues.
- d) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- e) Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.
- f) Organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë.
- g) Vendos për taksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- h) Vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.
- i) Vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshi subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë.
- j) Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.
- k) Zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut.
- l) Vendos për dhënien ose heqjen e mandatit të këshilltarit.
- m) Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.
- n) Vendos për simbolet e bashkisë.
- o) Vendos për emërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të institucioneve dhe të objekteve në juridiksionin e bashkisë.
- p) Jep tituj nderi dhe stimuj.
- q) Vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim tek bashkia.

Shtojca 4 – Ngritja dhe Funksonimi i NJMF-ve, Një Proces Hap pas Hapi

I. Kompetencat dhe Aftësitë e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve

Personi që konkuron për të patur pozicionin e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki/Komunë duhet të ketë kualifikimet, njohuritë, kompetencat dhe shprehitë e mëposhtme:

Kualifikimet dhe Njohuritë:

- Diplomë në Punë Sociale (Master në Punë Sociale ose në fusha të lidhura me fëmijët dhe familjen është i preferuar).
- Njohuri shumë të mira në fushën e zhvillimit të fëmijëve, mbrojtjes, pjesëmarrjes si dhe të drejtave të fëmijëve
- Shprehi shumë të mira për të punuar drejtpërdrejt me fëmijët dhe familjet në nevojë përmes teknikave, përjasjeve bashkëkohore në punën sociale me fëmijët dhe familjen.
- Njohuri të mira mbi aspektet etike në punën me fëmijët në nevojë për mbrojtje.
- Përvojë në programe komunitare, me qendër fëmijët dhe familjet vulnerabel.
- Njohuri shumë të mira në funksionimin e pushtetit lokal dhe shërbimeve sociale, mjekësore, arsimore në nivel lokal për fëmijët dhe familjen.
- Të ketë njohuri shumë të mira mbi aspektet sociale, kulturore, përkatësisë gjinore, çështjeve të pakicave etnike etj, të cilat janë faktorë që ndikojnë në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.

Shprehitë dhe Kompetencat:

- Aftësi komunikimi dhe lehtësuese në punën me fëmijët, familjen dhe komunitetin.
- Aftësi për të punuar në grup dhe për të drejtuar punë në grupe multidisiplinare.
- Aftësi shumë të mira për të ndërtuar partneritete me aktorë të ndryshëm.
- Aftësi shumë të mira të grumbullimit të informacionit, analizës, sintetizimit dhe hartimit të raporteve me fokus çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Integritet të lartë profesional në punën me fëmijët.
- Të jetë krijues dhe iniciator në ndërmarrjen e veprimeve dhe realizimit të të gjitha aktiviteteve në interesin më të lartë të fëmijëve dhe në përputhje me Protokollin e NJMF-se dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve.
- Gjuhët e huaja janë të preferuara

2. Modele testimi për kandidatët për Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve

Procesi dhe Guida e Intervistës me Gojë

Shembull: Testimi me gojë për pozicionin e Punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Vlorë.

- Komisioni i përbërë nga 3 përfaqësues të Bashkisë Vlorë respektivisht Shefi i Kabinetit të Zyrës së Kryetarit, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtore e Shërbimit Social të Bashkisë dhe 2 specialistët, përfaqësues të organizatës mbështetëse,

Terre des hommes:

- Kohëzgjatja 30-35 minuta për një kandidat. Pyetjet drejtohen nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe secili prej tyre mund të bëjë pyetje shtesë për të kuptuar më mirë dhe për të marrë informacionin e kërkuar.
- Specialisti i parë bën një prezantim të shkurtër të projektit (NJMF), të detyrave kryesore të PMF edhe një prezantim të komisionit, ose çdo anëtar i komisionit prezantohet vete (koha 5 minuta)

Pyetjet:

- ✓ Trego për veten dhe eksperiencat e punës (Koha 5-7 minuta)
- ✓ Çfarë ju bën juve një kandidat të mirë për këtë pozicion? (Koha 4 minuta)
- ✓ Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta që i njohni vetes? (Koha 4 minuta)
- ✓ Sipas mendimit tuaj cilat mund të jenë disa prej karakteristikave kryesore që duhet të ketë një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve? (Koha 3 minuta)
- ✓ Sipas mendimit tuaj, cilat janë disa prej problematika që çenojnë të drejtat e fëmijëve në Shqipëri? Po në komunitetin tuaj? (Koha 4 minuta)
- ✓ Cilat janë dokumentet kryesore në rang ndërkombëtar dhe kombëtar që parashikojnë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve? (Koha 2 minuta)
- ✓ A keni menaxhuar buxhete për zbatimin e aktiviteteve sociale/çaktivitete të tjera me fëmijët apo grupe të tjera? (Koha 3 minuta)
- ✓ Çfarë mund të pengojë punën tuaj? (faktore personale të brendshëm dhe të jashtëm) (Koha 3 minuta)
- ✓ Sa mundësi keni të udhëtoni jashtë Vlorës sipas nevojave të shërbimit të NJMF-ve? (Kjo i bashkangjitet pyetjes 8) (Koha 1 minutë)
- ✓ Në rast se përzgjidheni, kur mund të jeni diponibël për të filluar punë në këtë pozicion? (Koha 1 minutë)

Procesi dhe Modeli i Testimit me Shkrim

Shënim: Meqënëse njohja e anglishtes nga kandidati bërben avantazh, duke konsideruar faktin që NJMF-ja mbështetet edhe nga organizata e donatorë të huaj, atëherë një nga pyetjet e testimit me shkrim mund të jetë në anglisht dhe përgjigja të kërkohet në këtë gjuhë. Kjo i shërben anëtarëve të komisionit të vlerësojnë nivelin e gjuhës së huaj tek kandidatët që janë selektuar për t'u testuar.

Kërkohet që çështjeve të shkruara në anglisht t'u jepet përgjigja po në këtë gjuhë, pra anglisht. Ju faleminderit dhe suksese!

Koha 50-60 minuta

Pyetjet:

- ✓ Përshkruani kuptimin e konceptit "Mbrojtja e Fëmijëve"
- ✓ Listoni disa ofrues shërbimesh të cilët luajnë rol në mbrojtjen e fëmijëve, në qytetin e Vlorës
- ✓ Në rast se do të jeni ju Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe do ju duhet edhe të raportoni periodikisht, cili do të ishte për ju modeli i një forme raportimi?
- ✓ Në kuadër të aktiviteteve për mbrojtjen e fëmijëve (parandaluese/ndërgjegjësuese/ edukative), ju lutem hartoni një aktivitet dhe bashkangjitini buxhetin e nevojshëm për realizimin e tij. (Kjo pyetje mund të bëhet në anglisht dhe kërkohet t'i kthehet përgjigja në anglisht)

3. Hapat kryesorë për organizimin dhe zhvillimin e prezantimit të NJMF-së

- a) Përgatitja e listës së pjesëmarrësve (pjesëmarrësit janë nga niveli qendror, rajonal, lokal, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar, shoqëria civile, prindër, fëmijë)
- b) Përzgjedhja e vendit të kryerjes së aktivitetit. Zakonisht Bashkia/Komuna zgjedhin vende të cilat janë në pronësi të tyre dhe po ashtu të njohura nga qytetarët
- c) Përgatitja e ftesës dhe axhendës së aktivitetit prezantues, printimi dhe firmosja e tyre nga kryetari i Bashkisë/Komunës apo edhe përfaqësues i organizatës/institucionit mbështetës.
- d) Përgatitja e komunikatës për shtyp. Me anë të kësaj synohet prezantimi i NJMF-së edhe nëpërmjet medias për të shpërndarë informacionin sa më gjerë. Kjo komunikatë përgatitet mbi një format i cili hapet me informacionin mbi datën, vendin, orën e aktivitetit, kush e zhvillon aktivitetin dhe kush e mbështet, çfarë është NJMF-ja dhe funksioni i saj, cilët do të jenë folësit dhe ku do të bazohet fjala e tyre, informacion mbi punën e deritanishme të NJMF-së shoqëruar me tregues shifror, dhe mesazhe përcjellëse sipas nevojave. Në fund të komunikatës për shtyp vendosen kontaktet e dy personave, njëri është Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe tjetri një përfaqësues nga Bashkia/Komuna ose nga organizata mbështetëse. *(Gjithsesi këtë e vendos Bashkia/Komuna sipas nevojave dhe pritshmërive).*
- e) Përgatitja e banerit, i cili përmban subjektin e takimit p.sh PREZANTIMI I NJËSISË PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, logon e Bashkisë/Komunës përkatëse dhe logo tjetër sipas kontributit që mund të jetë dhënë. (Sugjerohet që logot e tjera të jenë të lëvizshme lehtësisht nga baneri në mënyrë që i njëjti baner të përdoret nga NJMF-ja edhe për aktivitete të tjera ku nevojitet edhe promovimi i kësaj strukture.
- f) Kthimi i ambientit të zgjedhur për zhvillimin e aktivitetit prezantues në një ambient të përshtatshëm për këtë aktivitet.
- g) Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve përgatit prezantimin e tij/saj, i cili do të bazohet mbi kuadrin ligjor që mbështet ngritjen dhe funksionimin e NJMF-së, një informacion të përgjithshëm mbi shtrirjen e NJMF-ve të tjera në zona të ndryshme të Shqipërisë, NJMF-në në strukturën e Bashkisë/Komunës (roli i NJMF-së, funksioni, detyrat e PMF, mjetet mbështetëse për njësinë, partneriteti lokal dhe bashkëpunëtorët më të ngushtë të NJMF-së, njohjen me problematikat e fëmijëve të zonës, tregues të punës së dertanishme të njësisë), hapa të mëtejshëm për të forcuar punën për mbrojtjen e fëmijëve dhe në fund mesazhe drejtuar aktorëve për një angazhim të përbashkët, për t'i dhënë fëmijëve shanse të gëzojnë fëmijërinë dhe të rriten të shëndetshëm.
- h) Nëse fëmijët janë pjesë e këtij aktiviteti, ata mund të debutojnë me këngë, recitime, pjesë teatrale etj, për të dhënë mesazhet e tyre në këtë aktivitet. Këta fëmijë ndihmohen të parapërgatiten dhe mbështeten për interpretimin e tyre bazuar në parimet e punës me ta.
- i) Përgatitja e dosjes për pjesëmarrësit (axhenda, fletëpalosje e NJMF-ve, materiale të tjera promovuese/ndërgjegjësuese, etj.)
- j) Përgatitja e listë-prezencës së pjesëmarrësve (emër mbiemër, insitucioni që përfaqëson, pozicioni, numër telefoni, adrese emaili)
- k) Nëse programi i këtij aktiviteti përmban koktej, duhen marrë masat për organizmin e tij.

Shtojca 5 – Ndërtimi i Kapaciteteve të Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Tematikat kryesore të trajtuara në Paketën Bazë Orientuese janë:

1. Koncepte bazë për Mbrojtjen e Fëmijëve. Mbrojtja, mirëqënia dhe të drejtat e fëmijëve. Njohja me qasjen sistematike në adresimin e abuzimit ndaj fëmijëve.
2. Koncepte bazë të abuzimit, zhvillimit të fëmijës dhe përfaqësive kryesore në punën për mbrojtjen e fëmijëve.
3. Protokollin e Punonjësit të NJMF-së; përdorimi në praktikë.
4. Rolet dhe Përgjegjësitë e NJMF-së, aktorëve përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve. Hartëzimi i Shërbimeve për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës dhe familjes.
5. Vlerësimi dhe Manaxhimi i Rastit- udhëzim hap pas hapi.
6. Kuptimi i Kapaciteteve dhe Vulnerabilitetit të fëmijës dhe familjes.
7. Raportimi dhe Monitorimi i shërbimit të NJMF-së. Krijimi i dosjes, aspekte të konfidencialitetit dhe trajtimit etik të rastit.
8. Korniza Ligjore në punën për mbrojtjen e fëmijës.
9. Puna me Familjen, ndërhyrjet e hershme dhe modelet alternative të përkujdesit për fëmijët.
10. Puna e drejtpërdrejtë me fëmijën, pjesëmarrja dhe fuqizimi i fëmijëve. Modele për aktivitete parandaluese me qendër fëmijët.

Moduli i Kurrikulës për PMF / drejtuesit e shërbimeve sociale dhe Aktorët e Mbrojtjes së Fëmijëve

Tema	Çështjet
Kuptimi i fëmijërisë dhe organizimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Mbrojtjes Sociale.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërtimi social i fëmijëve ▪ Të drejtat e fëmijëve ▪ Sistemi i mirëqënies sociale në Shqipëri ▪ Sistemet e mbrojtjes së fëmijëve kundrejt sistemeve tematike ▪ Mbrojtja sociale dhe lidhjet e saj me mirëqënien e fëmijës
Nevojat e fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillimi i fëmijës dhe nevojat bazë ▪ Psikologjia e fëmijës- teoria e atashimit dhe e sjelljes së mësuar ▪ Promovimi i resiliencës- karakteristikat e fëmijëve resiliente
Abuzimi i fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizimi i abuzimit ▪ Llojet e abuzimit ▪ Faktorët e rrezikut ▪ Shenjat dhe simptomat e llojeve të ndryshme të abuzimit

Procesi i Vlerësimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Procesi i vlerësimit ▪ Dimensionet që duhen vlerësuar ▪ Përfshirja e fëmijëve dhe familjeve në vlerësim ▪ Identifikimi nevojave ▪ Analiza e rrezikut dhe menaxhimi ▪ Koncepti i “ prindërimit të mirë mjaftueshëm”
Ndërhyrja paraprake Puna me familjet dhe vizitat në familje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptuarit e vazhdimësië së shërbimit dhe ndërhyrjes ▪ Aktivitet parandaluese ▪ Ndërhyrja paraprake dhe mbështetja e familjes ▪ Menaxhimi i vizitës në familje ▪ Aftësitë për intervistimine familjes ▪ Aftësitë vëzhguese - çfarë duhet të vëzhgojmë ▪ Përfshirja e familjes në proces
Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizimi i mbrojtjes dhe momenti i ndërhyrjes ▪ Hapat e investigimit ▪ Zhvillimi i planeve për mbrojtjen e fëmijëve ▪ Pasqyrimi i shërbimeve të duhura për mbrojtjen e fëmijëve ▪ Proçesi i rehabilitimit dhe rigjenerimit
Puna e drejtpërdrejtë me fëmijët dhe Fuqizimi i fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aftësitë për te komunikuar me fëmijët për vjeljen e këndvështrimeve të tyre ▪ Si dhe kur përfshihen fëmijët në proçes
Kujdesi alternativ	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shmangia e ndarjes-koncepte dhe metoda/puna me familjen ▪ Modele të kujdesit alterantiv për fëmijët dhe përshtatshmëria ▪ Praktika të mira për t’u ndjekur kur fëmijët ndodhen në këtë kujdes ▪ Promovimi i kontakteve me familjen/ të afërmit etj
Kuadri ligjor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ligji për dhunën i lidhur me fëmijën dhe familjen ▪ Politikat dhe proçedurat shqiptare në lidhje me fëmijën dhe familjen

Menaxhimi i rastit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Proçesi i menaxhimit të rastit në Shqipëri- hapat dhe afatet kohore ▪ Planet e kujdesit ▪ Kuptimi i menaxhimit të rastit dhe lidhjet e tij me mbrojtjen e fëmijëve ▪ Kërkesat për ruajtjen e të dhënave duke përfshirë edhe sistemin elektronik të të dhënave
Rolet dhe përgjegjësitë e Aktorëve në Mbrojtjen e Fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Praktika etike për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve ▪ Roli i punonjësit social/punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve ▪ Roli i agjencive të tjera kyç (policia, shëndeti, arsimi, OJF-të, etj.) ▪ Zhvillimi i bashkëpunimit dhe partneritetet

Referencat

“ABC of European Union for Local Government Units”, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Ministria e Punës Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Terre des homes dhe UNICEF, “Protokolli i Punës së Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve”, Qershor 2010.

“Mayors Manual”, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Rep.Shqipërisë, R. e. (2010, dhjetor). Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. *Botimi Qendrës së Publikimeve Zyrtare*, pp. 8287-8299.

Rep.Shqipërisë, R. e. (2010, dhjetor). Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. *Botimi Qendrës së Publikimeve Zyrtare*. Ligji Nr. 9355 për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore, datë 10.03.2005, Neni 4, Pika 15.

Rep.Shqipërisë, R. e. (2010, dhjetor). Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. *Botimi Qendrës së Publikimeve Zyrtare*. Ligji Nr. 9355 për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore, datë 10.03.2005 Neni 6, dhe Neni 13, pika 1.

Laci V., Lopari E., Sendrine C.. (n.d.) (2011). Exploring Synergies between Social Protection and Child Protection. Puna Sociale dhe Politika Sociale. Revistë Shkencore Nr. 3, 2011. Dajti 2000. Tiranë.

OSCE-Prezenca në Shqipëri, Këshilli i Europës, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, “ Menaxhimi i Performancës dhe Planifikimi Financiar - Në mbështetje të Planifikimit të Komuniteteve Vendore, Manual për Bashkitë Shqiptare”.

OSCE-Prezenca në Shqipëri, Këshilli i Europës, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë “Guida kombëtare për planifikimin e zhvillimit të komunitetit.

Westwater G., J. V. (2009). *Vlerësimi i Ndërhyrjes së Njësive për mbrojtjen e Fëmijëve në kuadër të reformave për mirëqenie sociale dhe procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale në Shqipëri. UNICEF & Austrian Development Cooperation*. Tiranë, Albania: UNICEF Albania.

LIGJ
Nr.10 347, datë 4.11.2010
PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika I të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;
- b) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;
- c) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- ç) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Autoritet shtetëror përgjegjës” është organi ose institucioni shtetëror, në nivel qendror a vendor, i cili, brenda fushës së veprimtarisë së tij, kryen dhe mbulon shërbime të specializuara e profesionale për fëmijët.
- b) “Dhunë ndaj fëmijëve” është përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i formave të tjera të forcës, qoftë me kërcënim ose aktuale, kundër fëmijës a grupit të fëmijëve, e cila rezulton apo ka shumë të ngjarë që të rezultojë në dëmtim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim.
- c) “Dhuna psikologjike” përfshin veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën.
- ç) “Dhunë fizike” është çdo tentativë ose çdo dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës,

përfshirë edhe ndëshkimin trupor të tij, të cilat nuk janë aksidentale.

d) “Fëmijë” është çdo person i lindur gjallë, deri në moshën 18 vjeç. Në rastin kur moshë e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa moshë e tij të jetë përcaktuar plotësisht.

dh) “Fëmijë në rrezik” është fëmija, të cilit i mohohen ose i cenohen të drejtat dhe mbrojtja e parashikuar në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

e) “Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijëve dhe praktikën e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjinitale dhe martesë e fëmijëve.

ë) “Multidisiplinar” është vlerësimi i koordinuar ligjor, social, psikologjik, shëndetësor, arsimor dhe kulturor i gjendjes së fëmijës.

f) “Ndëshkimi trupor” është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto, nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, të afërmit ose çdo person tjetër ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Në ndëshkimin trupor përfshihen forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja/shytyja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.

g) “Ndërhyrje e paligjshme për ruajtjen e identitetit” është moslejimi i përdorimit të gjuhëve të pakicave kombëtare në sistemin arsimor e në media; persekutimi shtetëror apo shtypja e besimit fetar; mosnjohja e mundësisë për fëmijët jashtë kujdesit prindëror, të cilët janë vendosur në institucione, familje kujdestare apo të birësuar, që të gëzojnë trashëgiminë e tyre etnike, kulturore, gjuhësore dhe fetare.

gj) “Prind” është personi/personat që e kanë lindur ose e kanë birësuar fëmijën të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

h) “Përfaqësues ligjor” është kujdestari ose familja kujdestare, personi apo institucioni, i cili, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës.

i) “Prostitucion i fëmijëve” është përdorimi i fëmijëve në veprimtaritë seksuale, me qëllim shpërblimi ose çdo formë tjetër që konsiderohet shpërblim;

j) “Pornografi e fëmijëve” është prodhimi, shpërndarja, importimi, eksportimi, mbajtja, ofrimi, shitja, shfaqja, transmetimi i fotove, filmave apo çdo material tjetër vizual, që paraqet fëmijën duke kryer çdo lloj aktiviteti seksual ose që tregon pjesët gjinitale të fëmijës, për qëllime seksuale ose çdo lloj tjetër përfitimi.

k) “Shitje e fëmijëve” është çdo veprim ose transaksion, me anë të të cilit fëmija transferohet nga një person a grup personash te një tjetër me anë të shpërblimit ose me qëllim të përfitimit material apo çdo lloj përfitimi tjetër. Shitja e fëmijëve përfshin dorëzimin ose pranimin me çfarëdolloj mjeti të një fëmije për qëllime të shfrytëzimit seksual, transferimin e organeve të një fëmije me qëllim përfitimi, si dhe përfshirjen e një fëmije në punë të detyruar.

l) “Neglizhenca e fëmijës” është mosdhënia dhe mospërmbushja e nevojave të fëmijës për strehë, siguri, mbikëqyrje, ushqim, shëndet dhe arsim.

ll) “Organizatë jofitimprurëse” është organizata e krijuar në përputhje me legjislacionin për organizatat jofitimprurëse, që ka si objekt të veprimtarisë së saj, të përcaktuar në statut dhe/ose në aktin e themelimit, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për mbrojtjen e të drejtave:

- a) të fëmijës që ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) të fëmijës me shtetësi shqiptare që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Parime të përgjithshme

Mbrojtja e të drejtave bëhet duke garantuar:

1. Interesin më të lartë të fëmijës, si konsideratë mbizotëruese, në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga ofruesit publikë apo privatë të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative ose legjislative.
2. Barazinë dhe asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij.
3. Eliminimin e të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinioneve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.
4. Respektimin e përgjegjësive, të të drejtave dhe të detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për fëmijën.
5. Krijimin e kushteve për mbijetesë maksimale dhe për zhvillim.
6. Parimin e respektimit të mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.

KREU II

TË DREJTAT DHE MBROJTJA E FËMIJËS

Neni 6

E drejta e jetës, e mbijetesës dhe e drejta për zhvillim

1. Fëmija ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar e për të gëzuar mirëqenie dhe kujdes shëndetësor bazë. Fëmijës i garantohet gëzimi i standardeve më të larta të mundshme të shëndetit dhe të trajtimit e të rehabilitimit. Fëmija ka të drejtë të ketë akses te këto shërbime shëndetësore.
2. Prindërit/përfaqësuesit ligjorë kanë përgjegjësi parësore të krijimit të kushteve të jetesës për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijëve të lindur nga martesë dhe jashtë martesë.

Neni 7

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe për të ruajtur identitetin

1. Fëmija, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka të drejtë:
 - a) të regjistrohet menjëherë me lindjen e tij;
 - b) të ketë një emër;
 - c) të fitojë shtetësinë;
 - ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve aq sa është e mundur.
2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje

të paligjshme.

3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë dhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihma mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:

- a) gjetjen e prindërve;
- b) gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijëve refugjatë e azilkërkues, me qëllim bashkimin familjar;
- c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.

Neni 8

E drejta për të qëndruar me prindërit

1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të tij.

3. Prindi/përfaqësuesi ligjor nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

4. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtari i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, të arrestuar, të burgosur, të internuar, të dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkak, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij.

5. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendndodhjen e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës.

Neni 9

E drejta për ribashkim familjar

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të hyrë ose për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë për arsye të ribashkimit familjar me prindërit e tij. Kjo kërkesë trajtohet në një frymë pozitive, njerëzore e të shpejtë dhe refuzohet vetëm në rastin kur ka arsye për të dyshuar se hyrja ose largimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Në rast se prindërit janë migrantë të paligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe fëmija ka fituar shtetësinë shqiptare, prindërit lejohen të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë e të mos largohen nga vendi.

Neni 10

E drejta për të siguruar kthimin

1. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, me vendim gjykate.

2. Fëmija i pashoqëruar nga prindi/përfaqësuesi ligjor ka të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë, pranë tyre.

3. Prindi/përfaqësuesi ligjor i fëmijës, ose çdo person që merr dijeni për humbjen e tij

duhet të njoftojë, brenda 24 orëve, autoritetin shtetëror përgjegjës për të bërë të mundur kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës.

4. Procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhësimin e fëmijëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje ndërkombëtare me vendet e tjera.

Neni 11

E drejta e shprehjes

1. Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën e pjekurinë e tij.

2. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të marrë dhe për të përcjellë informacione e ide të çdo lloji, në çdo formë ose me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur cenohet një interes publik ose të drejtat e të tjerëve.

3. Fëmija ka të drejtë të dëgjohej në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, drejtpërdrejt, ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor dhe në praninë e detyrueshme të psikologut, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Fëmijës i garantohet liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.

2. Prindi/përfaqësuesi ligjor i fëmijës e drejton atë në ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në përputhje me zhvillimin e aftësitë e tij.

Neni 13

Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore

1. Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore.

2. Ushtrimi i kësaj lirie bëhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

Neni 14

Liria e jetës private

1. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.

2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshi brenda familjes, institucioneve të përkujdesjes shoqërore dhe të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, përfshi të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

3. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, përfshi çështjet penale dhe të raportimeve në media.

Neni 15

E drejta për të marrë informacion

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë ose të marrë çdo lloj informacioni në lidhje me mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e tij fizik dhe psikologjik.

2. Fëmijët duhet të kenë akses në të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për ta.

Neni 16

E drejta për arsimim

Fëmija ka të drejtë të arsimohet në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me nivelin e zhvillimit mendor dhe fizik të tij.

Neni 17

E drejta për pushime dhe argëtime kulturore e sportive

Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore e artistike, në përshtatje me moshën e tij.

Neni 18

E drejta për nivel jetese të përshtatshëm

Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Neni 19

E drejta për kujdes shëndetësor

1. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor të përshtatshëm dhe për përfitim nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit.

2. Garantimi i kësaj të drejte bëhet, në veçanti, duke marrë masa:

a) për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;

b) për t'i siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore e kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;

c) për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të sigurimit, ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe të ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

ç) për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;

d) për të mundësuar që të gjitha grupet shoqërore dhe, në veçanti, prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi e të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën e përmirësimin e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;

dh) për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

Neni 20

E drejta për mbrojtje sociale

1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet prindit/përfaqësuesit ligjor, mbrojtje sociale, përfshirë dhe sigurimet shoqërore.

2. Mbrojtja, kur është e nevojshme, duhet të jepet duke pasur parasysh të ardhurat e kushtet e fëmijës e të personave përgjegjës për mbajtjen e tij, si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë, të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Neni 21

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës

Fëmija mbrohet nga çdo formë e:

a) dhunës fizike dhe psikologjike;

b) ndëshkimit trupor dhe trajtimit poshtërues e denigrues;

c) diskriminimit, përjashtimit dhe fyerjes;

ç) keqtrajtimit dhe braktisjes;

d) mospërfilljes dhe neglizhimit;

dh) shfrytëzimit dhe abuzimit;

e) dhunës seksuale.

Neni 22

Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik

1. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune që:
 - a) paraqet rreziqe;
 - b) cenon edukimin;
 - c) dëmton shëndetin;
 - ç) dëmton zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror;
 - d) është e detyruar.
2. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija nga moshja 14 deri në 18 vjeç mund të punësohet në punë të lehta që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tij, sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 23

Mbrojtja nga përdorimi i substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope

Fëmija mbrohet nga:

- a) përdorimi i substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope;
- b) prodhimi dhe trafiku i paligjshëm i këtyre substancave.

Neni 24

Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe e keqtrajtimit seksual

Fëmija mbrohet nga trafikimi, nxitja, si dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e keqtrajtimit seksual, duke iu garantuar mbrojtja nga:

- a) veprimtaria e paligjshme seksuale;
- b) prostitucioni ose nga praktika të tjera seksuale të paligjshme;
- c) shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike;
- ç) shitja e fëmijëve.

Neni 25

Mbrojtja nga përfshirja në konfliktet e armatosura

1. Fëmija nuk lejohet të përfshihet drejtpërdrejt dhe tërthorazi në një konflikt të armatosur.
2. Në rast konflikti të armatosur, fëmijës i garantohet një respekt i veçantë dhe mbrojtje nga çdo formë sulmi të paligjshëm. Gjatë konfliktit fëmijës i sigurohet kujdes e ndihmë e veçantë, në përputhje me moshën dhe për çdo arsye tjetër.
3. Nëse arrestohet ose ndalohet për arsye, që lidhen me konfliktin e armatosur, fëmija do të mbahet në mjedise të veçanta nga të rriturit, përveç rasteve kur është ndaluar me familjen e tij.

Neni 26

Mbrojtja e fëmijës nga tortura, dënimi, trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues

Fëmija nuk i nënshtrohet torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 27

Mbrojtja e fëmijës që i është hequr apo kufizuar liria

1. Fëmijës nuk i mohohet liria në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare.
2. Fëmijës, që i është hequr apo kufizuar liria, i sigurohet ndihmë juridike e psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit penal, në përputhje me interesat e tij.

Neni 28

Ushtrimi i kujdesit prindëror

1. Prindi/përfaqësuesi ligjor ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.

2. Prindi/përfaqësuesi ligjor, për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, ka të drejtë t'u kërkojë autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar për mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor e administrimin e pasurisë së fëmijës.

Neni 29

Përkujdesja alternative

1. Fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis, i sigurohet një përkujdesje alternative.

2. Përkujdesja alternative mund të jetë:

a) vendosja në një familje birësuese;

b) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesit për fëmijët.

3. Zgjedhja e një prej alternativave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni bëhet në përputhje me:

a) procesin e vazhdimësisë së edukimit të fëmijës;

b) nivelin e aftësive fizike dhe psikike të fëmijës;

c) veçoritë e karakterit dhe të personalitetit të fëmijës, që lidhen me origjinën e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

4. Për zgjedhjen për fëmijën, për të cilin/cilën është e pamundur të kujdeset prindi i tij/saj, ndiqet kjo shkallë përparësie:

a) vendosja e fëmijës pranë pjesëtarëve të tjerë të familjes së fëmijës, përfshirë këtu edhe anëtarët e familjes në kuptimin e gjerë të konceptit "familje", duke nënkuptuar anëtarët e familjes së zgjeruar;

b) nëse zgjedhja, sipas shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni, nuk është e mundur ose nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, fëmija vendoset në një familje alternative;

c) nëse zgjedhja, sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 2 të këtij neni, nuk është e mundur ose nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, në alternativë të fundit, fëmija mund të vendoset në një institucion të përkujdesjes sociale.

5. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e një prej alternativave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.

Neni 30

Fëmija me aftësi të kufizuar

1. Fëmija me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike ushtron të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj, në përputhje me nivelin e zhvillimit të tij.

2. Fëmija me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike gëzon përkujdesje të veçantë, e cila jepet falas nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindit/përfaqësuesit ligjor të tij.

3. Përkujdesi i veçantë përcaktohet për t'i siguruar fëmijës me aftësi të kufizuara qasje efektive në arsimim, trajnim, shërbime të kujdesit shëndetësor, shërbime të rehabilitimit, përgatitje për punësim dhe argëtim, duke zhvilluar mundësitë e tij individuale në mënyrë të favorshme, për arritjen e integritit të plotë të mundshëm social, kulturor dhe shpirtëror.

Neni 31

Fëmija që i përket pakicave kombëtare

Fëmija që i përket pakicave kombëtare ushtron të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj, duke shprehur lirisht përkatësinë e tij etnike, kulturore, fetare e gjuhësore.

KREU III

MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Neni 32

Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

1. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.

2. Mekanizmat në nivel qendror janë:

- a) Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;
- b) ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- c) Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

3. Mekanizmat në nivel vendor janë:

- a) njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut;
- b) njësia për mbrojtjen fëmijës në bashki/komunë.

4. Mekanizmat në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Këta mekanizma bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

1. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është organ këshillimor ad hoc, që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

2. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe përbëhet nga 9 përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, 1 përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Bashkive dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile.

3. Përfaqësuesit nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës duhet të jenë shtetas shqiptarë, të cilët të kenë njohuri dhe të kenë marrë pjesë në veprimtari të shquara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës përzgjedh, me një procedurë konkurrimi të hapur, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ia propozon Kryeministrit për anëtarë të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

4. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të Këshillit në të njëjtën kohë ndalohej.

5. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës e të komiteteve teknike këshilluese të tij përcaktohen në rregulloren e këtij Këshilli, e cila

miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 34

Detyrat e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka këto detyra:

- a) bashkërendon politikat shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shoqërore, arsimore, shëndetësore dhe kulturore;
- b) i propozon ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës programet kryesore shtetërore për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës dhe drejtimin e politikave shtetërore për përmirësimin e gjendjes së trajtimit të tyre;
- c) vlerëson gjendjen konkrete të respektimit të të drejtave të fëmijës në Shqipëri, duke nxjerrë udhëzime dhe duke dhënë rekomandime të posaçme për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;
- ç) analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për mbrojtjen e fëmijës;
- d) rekomandon shërbime dhe programe që janë specifikisht të orientuara për fëmijët dhe familjet e tyre, kryesisht të atyre që kanë nevojë për mbrojtje emergjente;
- dh) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

Neni 35

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës

- I. Ministri që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse që ka për këtë qëllim:
 - a) harton politika dhe programe shtetërore në fushën e mbrojtjes së fëmijës;
 - b) mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për fëmijët, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së fëmijës;
 - c) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera për garantimin e të drejtave të tyre, kryesisht, dhe në bazë të rekomandimeve të propozuara nga Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;
 - ç) bashkërendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës;
 - d) kontrollon veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe miraton raportin vjetor të saj për ecurinë e realizimit të mbrojtjes së fëmijës;
 - dh) nxjerr udhëzime metodologjike për veprimtarinë e njësive të të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;
 - e) orienton mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët;
 - ë) ofron mbështetje për organizatat jofitimprurëse në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”;
 - f) bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për bashkëpunim me ministrin që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës, në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

3. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyra e procedimit të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është person juridik, në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës, financuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorë të ndryshëm.

2. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës, pas përfundimit të një procesi konkurrimi të hapur.

3. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen nga Kryeministri, me propozim të ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës.

4. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës përcaktohen në rregulloren e Agjencisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Detyrat e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka këto detyra:

a) të monitorojë dhe të kontrollojë zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit të saj, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të legjislacionit në fuqi në këtë fushë;

b) t'i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

c) të përgatisë dhe t'i propozojë ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijëve udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave e të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;

ç) të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Europian në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

d) t'i japë mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

dh) të bashkërendojë punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së fëmijës;

e) të organizojë dhe të bashkërendojë kërkimet shkencore dhe veprimtaritë informuese në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

ë) të ndërtojë dhe të realizojë veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit gjyqësor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera;

f) të ndërtojë mekanizmat e mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe të mbikëqyrë mbledhjen dhe

përpunimin e tyre;

g) të unifikojë të dhënat statistikore për çështjet që lidhen me fëmijët, në bashkëpunim me mekanizmat institucionalë në nivel vendor për mbledhjen dhe përpunimin e përgjithshëm të tyre;

gj) të realizojë mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informacionit për promovimin e respektimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

h) t'i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

i) të zhvillojë dhe të mirëmbajë sistemin e informacionit për:

- institucionet e specializuara për fëmijët dhe personat e kontaktit;

- organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

- të dhëna të tjera që lidhen me mbrojtjen e fëmijës;

j) të koordinojë burimet e ndryshme të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve;

k) të vendosë gjobë ndaj shkelësve të ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 40 të këtij ligji.

l) të bashkërendojë veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me Agjencinë, për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të të dhënave të tjera të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

3. Llojet, mënyra e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, ndaj shkelësve të të drejtave të fëmijëve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut

I. Njësia për të drejtat e fëmijës, që funksionon brenda strukturës administrative të këshillit të qarkut, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale, ka për detyrë:

a) të monitorojë dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;

b) të identifikojë dhe të koordinojë referimin e rasteve të shkeljeve apo të abuzimit, të keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut;

c) të koordinojë funksionimin e grupit multidisiplinar, për identifikimin, analizën dhe referimin e rasteve të dhunës në familje në territorin e qarkut;

ç) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacionin për trajtimin e të drejtave të fëmijës me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të qeverisjes vendore, në bashki dhe komuna, apo të shoqërisë civile;

d) të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për të drejtat e fëmijës në qark;

dh) t'i raportojë këshillit të qarkut për ecurinë e respektimit të të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;

e) t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar, për gjendjen e të drejtave të fëmijës në qark;

ë) t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

informacione për situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijës në qark.

2. Pranë këshillit të qarkut krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e qarkut.

Neni 39

Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë

1. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe ka për detyrë:

a) të vlerësojë dhe të monitorojë në vazhdimësi situatën e familjeve të fëmijëve në rrezik, derisa fëmija të konsiderohet “jo në rrezik”;

b) të bëjë identifikimin dhe të bashkërendojë, në mënyrë multidisiplinare, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territorin e bashkisë/komunës;

c) të sensibilizojnë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

ç) të bashkëpunojë me administratorët e shërbimeve shoqërore, psikologët e shkollave, mjekun e familjes, autoritetet përgjegjëse të rendit, punonjësit socialë të qendrave të shërbimeve publike e jopublike, për përmirësimin e situatës së mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

d) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë/komunës mund të informohen apo të referohen te shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;

dh) t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

e) t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës.

2. Pranë bashkisë/komunës krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e bashkisë/komunës.

3. Në njësinë për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë të ketë, të paktën, një punonjës me formim në fushën e punës sociale.

KREU IV

SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 40

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 7, 8, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 21 dhe 26 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

a) personi fizik, nga 30 000 deri në 60 000 lekë;

b) personi juridik nga 60 000 deri në 120 000 lekë;

c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri në 80 000 lekë;

ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 30 000 deri në 80 000 lekë.

2. Procedura për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimin e gjobave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 41

Ankimi

Kundërvajtësi, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vënien e gjobës, mund të bëjë ankim në gjykatë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 10 pika 4, nenit 32 pikat 4 e 5, nenit 33 pika 5, nenit 35 pika 3, nenit 36 pika 4 dhe nenit 37 pikat 3 e 4 të këtij ligji.

Neni 43

Shfuqizime

Aktet ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 44

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin Nr. 6771, datë 15.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**



Terre des hommes Albania

Rruga "Faik Konica", Vila 19
PO Box 7426, Tirana - Albania
Tel/Fax: +355 (0) 42 46 88 11
Email: info@tdhalbania.org
Web: www.tdh-childprotection.org / www.tdh.ch

 Find us on Facebook Terre des hommes Albania

 Google+ Terre des hommes Albania

 twitter @TdhAlbania